



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Ekonomik MBA”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “UNIVERSITETI  
METROPOLITAN TIRANA”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

2. Dr. Petrit Dollani

Mars/2022

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit te ciklit te dyte Master i Shkencave në Ekonomik MBA ofruar nga Universiteti Metropolitan Tirana

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Metropolitan Tirana
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Ekonomik MBA
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 197, datë 28.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 374, Datë 23.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE/ 3 PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	17 Studentë v.a. 2020-2021
19	Komente / të tjera:	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I MËPARSHËM

Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit në zbatim të Vendimit Nr. 100, datë 03.11.2015 “Për akreditimin periodik të programit të studimit, të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Ekonomik-MBA”, janë si vijon:

- 1- Të rriten marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione homologe jashtë vendit
- 2- Të përmirësohet numri dhe pesha e stafit efektiv me tituj dhe grada

### ANALIZA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE

#### 1. Plotësimi i rekomandimit 1

**GVJ është e mendimit se ky rekomandim është përmbushur plotësisht nga institucioni.**

GVJ duke iu referuar dosjes se Vetëvlerësimit si dhe vizitës në institucion e takimeve me drejtuesit e fakultetit dhe të njësisë bazë, konstaton se institucioni ka marrë në konsideratë rekomandimet e lëna nga KA duke e bërë ndërkombëtarizimin një prej objektivave strategjikë të UMT. Në përmbushje të rekomandimit të KA dhe të këtij objektiv të vetë Institucionit, në listën e marrëveshjeve cituar në vijim, janë rreth 15 marrëveshje me institucione homologe të huaja, si Universiteti i Marche, Universiteti i Mesinës, Universiteti Suceava etj. [*75.FE Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në proces të FE.pdf; 22.UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf; 23.UMT Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE.pdf*]

Fokusi i këtyre marrëveshjeve shihet se është kryesisht në shkëmbimin e stafit dhe/ose të studentëve, në organizimin e konferencave të përbashkëta, në organizimin e programeve të përbashkëta, në aplikimin për projekte të përbashkëta etj.

**Për sa më sipër GVJ është e mendimit se rekomandimi është përmbushur**

#### 2. Plotësimi i rekomandimit 2

GVJ duke shqyrtuar dosjen e vetëvlerësimit si dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion në lidhje me prioritetet e institucionit për të rekrutuar staf akademik efektiv me tituj/grada dhe me eksperience, konstaton se gjatë vitit akademik 2020-2021, janë të përshirë në programin e studimit 19 pedagogë, ndër të cilët 10 janë personel akademik efektiv dhe 9 staf akademik me kontratë.

100% e stafit janë me tituj/grada, me konkretisht 32% (6 pedagogë), janë të kategorisë profesor dhe 68% mbajnë gradën shkencore doktor. Ndërkohë ky raport në stafin efektiv është: 20% janë me titullin akademik profesor dhe 80% mbajnë gradën shkencore doktor. Institucioni është i interesuar edhe në eksperiencën e gjatë në mësimsdhënie të stafit akademik dhe në hapësirën ndërkombëtare që ka rezultuar në rekrutimin si staf i jashtëm i dy pedagogëve të huaj me eksperience të gjatë akademike. [*Tabelat Permbledhese.pdf*]

**Për sa më sipër GVJ është e mendimit se rekomandimi është përmbushur**

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Metropolitan Tirana, u u licencua si një institucion i arsimit dhe kërkimit shkencor me VKM Nr. 357, date 12.05.2010.

Institucioni është akredituar me Urdhër Nr. 8 datë 07.01.2016, për herë të parë dhe u riakreditua me VBA Nr. 117 date 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri ne 14.12.2022.

Është miratuar Statuti i ri me emertimin Universiteti "Metropolitan Tirana", ky statut është miratuar me UMASR Nr. 611 datë 28.09.2018



Vendimet mbështetëse të Statutit janë: Vendimi i Bordit të Lartë Drejtues Nr. 935/2 date 26.07.2018 dhe Vendimi i Senatit Akademik Nr. 935/1 date 26.07.2018.

Programi i studimit Master i Shkencave "Ekonomik MBA", është lincensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, UMASH Nr. 197, datë 28.05.2013. Akreditimi i parë për këtë program studimi është përfunduar me Urdhër i MAS, Nr. 10, datë 07.01.2016.

Regjistrimi i Formës së Diplomës që lëshon UMT, është bërë me Urdhër Nr. 374, Datë 23.12.2019 për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, MSC në "Ekonomik - MBA" të Universitetit "Metropolitan Tirana"

Ky program studimesh ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe mbulohet nga Departamenti i Shkencave Administrative pranë UMT.

Ai shtrihet në 2 vite akademike dhe 4 semestra. Ka 120 ECTS me nga 60 kredite /për cdo vit studimi.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Ekonomik MBA”, filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin Metropolitan Tirana, u realizua gjatë datave 15 dhe 16 Shtator 2021, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (më tej GVJ) shoqëruar nga koordinatori teknik i ASCAL, i caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL.

Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Administrative, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e UMT. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzon raportin tek Koordinatorin Teknik i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL, Muhamed Prezja.

Me datë 15.03.2022 Universiteti Metropolitan Tirana, nëpërmjet sistemi të ASCAL AMS ktheu përgjigje duke shprehur dakordësinë me draft raportin dhe nuk ka asnjë koment. Drafti merr formën finale si më poshtë.

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, GVJ konstaton se në formulimin e vizionit dhe misionit të UMT është theksuar promovimi i vlerave akademike, profesionale, etike e qytetare, në programet e ofruara të studimeve. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ konstaton, nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ofruar të studimit, synimin e shprehur për zhvillim kërkimi shkencor në nivel kombëtar, duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera partnere brenda vendit, nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjive e metodave bashkëkohore. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, arriti në përfundimin, se programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin dhe statutin e UMT, veçanërisht me njëren prej dy shtyllave kryesore ku mbështetet aktiviteti i institucionit, fushën e Menaxhimit të Biznesit. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi, se në kuadrin e këtij programi studimi janë realizuar kërkime e aktivitete shkencore me interes kombëtar, ndër të tjera 3 konferenca studentore, një simpozium dhe një shkollë verore, si dhe egziston mundësia e shndërrimit të tyre në zbatime praktik, nëpërmjet njësisë së start up-ve. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 15.Lista e startup dhe incubator.pdf]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar	Bazuar në takimet e zhvilluar në institucion dhe shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, GVJ është i mendimit, se tërësia e njohurive shkencore, që përmbahen në syllabuset e lëndëve dhe aktiviteve të përfshira në programin e studimit, veçanërisht hartimi dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

6

profesional e shkencor	mbrojta e mikrotezës, mundësojnë krijimin e një baze të qëndrueshme, , për thellim të mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë. <i>[53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 48.UMT_Platformat per mesimin online.pdf, 93.FE_Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik të FE.pdf, 102.FE_Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në Ekonomik MBA konvergjon me zbatimin e strategjisë zhvillimore të institucionit, në drejtimin të rritjes së kompetencave dhe fuqizimit të kërkimit shkencor. Në veçanti kontributin kryesor në këtë drejtim e ka lënda “Metodat e kërkimit”, si dhe i gjithë procesi i përgatitjes së mikrotezave nga studentët nën drejtimin e udhëheqësve. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi, se programi i studimit është hartuar dhe ofruar në zbatim të prioritetëve akademike të shprehura në statutin dhe rregulloren e institucionit. Programi përputhet veçanërisht me nenin 1 të statutit, ku sanksionohet natyra akademike dhe shkencore UMT, me nenin 4 ku shtjellohet misioni i institucionit, si dhe me nenet e rregullores që kanë të bëjnë me parimet e përgjithshme, personelin akademik, pranimin e studentëve, kreditet, hartimin dhe rishikimin e planeve mësimore, format e kontrollit të dijeve dhe diplomimin. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të disponueshëm, arriti në përfundimin, se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është hartuar në përputhje me njërin prej dy shtyllave kryesore ku mbështetet aktiviteti i institucionit, fushën e Menaxhimit të Biznesit. <i>[3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, 53.FE_Të dhëna të</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

7

	<i>përgjithshme për programin e studimit.pdf</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	GVJ është i mendimit, se dokumentacioni i programit të ofruar të studimit, përmban përcaktime në formulimin e vizionit, misionit, fushave të përgjithshme dhe specifike të programit që konvergojnë me objektivat e strategjive kombëtare për zhvillim, me karakter ekonomik dhe shoqëror, sidomos aty ku bëhet fjalë për rritjen e kapacitetve të kërkimit shkencor dhe inovacionit, që konvergojnë me objektivat e strategjive kombëtare për zhvillim, me karakter ekonomik dhe shoqëror. [3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Bazuar në takimet e zhvilluar në institucion dhe shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, GVJ arriti në përfundimin, se programi i studimit përmban objektiva dhe aktivitete konkrete, që i pajisin studentët me njohuri, kopetenca dhe aftësi të duhura, për nivelin e studimeve master shkencor, që lidhen me kërkimin shkencor, lidhshërinë, etikën, dhe synojnë ti përgjigjen kërkesave aktuale në tregun e punës, në fushën e ekonomisë. Nga analiza e programit mësimor dhe metodave të mësimdhënies, u konstatua tendenca konstante për konkretizimin e njohurive teorike me aspekte dhe zbatime praktike, në realitetin botëror, por edhe në atë lokal, [53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se UMT ka kryer studime konkrete, të dedikuara mbi nevojat e tregut të punës në Shqipëri, lidhur me specialitetin që ofron ky program studimi master shkencor. Studimi i tregut dhe përditësimet e tij janë mundësuar nga rrjeti i bashkëpunimeve që ka institucioni me subjekte prodhuese, tregëtare, financiare etj. [23.UMT_Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FE.pdf, 74.FE_Studim tregu per programin.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve,	Pasi analizoi dokumentacionin e ofruar dhe zhvilloi takime në institucion, GVJ vlerëson, se programi i studimit ka respektuar kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen, strukturën, objektivat formues dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

8



<p>aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>rezultatet e pritshme të të nxënit, në mënyrë që dijet dhe aftësitë e të diplomuarve tju lehtësojnë atyre integrimin me tregun e punës. [53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 74.FE_Studim tregu per programin.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin e ofruar, në formën e programit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve gjykon, se programi i studimit është bazuar thuajse tërësisht në programe të ngjashme studimi të universiteteve ndërkombëtare, të tilla si UPEC Francë, Universiteti Masaryk Çeki, ËSB Poloni etj. gjë që ju lehtëson studentëve njohjen e lëndëve pas transferimeve të mundshme jashtë vendit, si dhe punësimin eventual në tregun ndërkombëtar. [53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, GVJ është i mendimit, se gjatë hartimit të programit të studimit janë mbajtur parasysh si dokumentat strategjike kombëtare mbi arsimin e lartë, ashtu edhe ato të BE-së. Gjithashtu konstatohen edhe referime në praktikat më të mira evropiane, veçanërisht të universiteteve nga vendet në tranzicion sistematik, të tilla si Bullgaria (Universiteti i Varnës), Rumania (Universiteti i Konstancës), etj. përshtatura me rrethanat dhe kushtet e institucionit. [3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin respektiv dhe realizoi takime në institucion, arriti në përfundimin, se programi i studimit ka krijuar kushte dhe mundësi reale, që të diplomuarit të realizojnë praktika profesionale, sipas qëllimeve dhe në funksion të realizimit efektiv të tij. Bazuar në Programin mbi zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, praktika është përcaktuar të zgjasë 2 muaj, në fushat: manaxhim dhe lidhshmëri, strategji dhe menaxhim operacionesh, strategji dhe shpërblim personeli, si dhe administrim dhe analizë financiare. UMT ka përdorur për këtë qëllim rrjetin e bashkëpunimit dhe kontakteve si me subjekte të tilla si kompani biznesi, institucione financiare, institucione shtetërore në nivel qendror dhe lokal, si dhe institucione kërkimore shkencore. [53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf, 88. FE_Seti i dokumentacionit të praktikës për programin e studimit.pdf]</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>GVJ, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe nga realizimi i takimeve në institucion, konstatoi se programi i studimit përmban disa lëndë që ofrohen në gjuhë të huaj, nga pedagogë të huaj, si psh. Strategji Marketingu nga prof. Sotiris Karagiannis, dhe Menaxhimi i Përgjithshëm i Cilësisë nga prof. Derek Mainëaring, duke krijuar kështu premiset e ndërkombëtarizimit të programit, dhe rritjen e shkëmbimeve të studentëve e stafit me universitete të huaja. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf, 72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të ofruar, GVJ arriti në konkluzionin, se për këtë program studimi vetëm një pjesë e dokumentacionit është e përgatitur dhe arkivuar në gjuhën angleze, por duhet të punohet më tej për ta shtuar këtë sasi dokumentash, me qëllim plotësimin e kriterit. [2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomise.pdf, 95.FE_Rregullore e Sekretarisë.pdf, 111.FE_Rregullore e arkivës.pdf]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi I.4</b> <b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të ofruar, GVJ krijoi vlerësimin, se në këtë program studimi institucioni ka krijuar një përvojë disavjeçare dhe i zotëron burimet e duhura në fushën akademike specifike. Në rradhë të parë kemi këtu parasysh angazhimin e stafit akademik me kohë të plotë, i cili në gjykimin tonë zotëron kopetencat e duhura, por edhe mjediset e duhura, sipas standarteve, për zhvillimin e procesit mësimor. [66.FE_Lista e plotë e personelit akademik me kohe të plotë, me kohë të pjesshme_FE_Tab.Nr.2.pdf, 67.FE_Lista e plotë e personelit ndihmës akademik dhe administrativ.pdf, 68.FE_Të dhëna statistikore të personelit akademik PAE_PAK_Tab.Nr. 1.pdf, 107.FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë</p>	<p>GVJ verifikoi, bazuar në dokumentacionin e ofruar se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, të ofruar nga Departamenti i Shkencave Administrative, është plotësisht në përputhje</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

10

<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë UMT. Ky verifikim mbajti parasysh edhe klasifikimin e programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve në nivel kombëtar, apo ato që vijnë nga BE. [1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, GVJ verifikoi, se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të lëvruar nga Departamenti i Shkencave Administrative, të Fakultetit të Ekonomisë UMT. Ky verifikim mbajti parasysh edhe klasifikimin e programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve në nivel kombëtar, apo ato që vijnë nga BE. [50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin në dispozicion dhe zhvilloi takimet në institucion, krijoi gjykimin se lidhur me këtë program studimi, UMT ka arritur të krijojë mekanizmat e duhur për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, duke ndarë në mënyrë të përshtatshme rolet dhe detyrat mes njësisë të tij përbërëse. Departamenti i Shkencave të Administrimit ka arritur të bashkëpunojë efektivisht me Departamentin e Financë Bankës dhe atë të Informatikës Ekonomike, për mbulimin e lëndëve të ofruara nga prej tyre në këtë program. [4.UMT_Organigrama Struktura e Rektoratit.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas</p>	<p>Në përfundim të takimeve të zhvilluara në UMT dhe të analizës së dokumentacionit respektiv, GVJ vlerëson se në lidhje me këtë program studimi janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit (SHBA, Francë etj.) Në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

11

dhe/ose të huaj.	bashkëpunimet lokale vlen të veçohet ai me UT dhe UPT, si për pedagogët e ftuar nga UMT, ashtu edhe për aktivitet kërkimore shkencore, si Konferenca Studentore, Shkolla Verore etj., ashtu edhe me subjekte private si banka (Raifesisen, Union), Bursa ALSE, Sigal, apo pushtetin lokal (Bashkia Tiranë) për garantimin e zhvillimit të duhur të praktikave mësimore. <i>[72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponueshëm, GVJ konstatoi një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi që UMT ka lidhur me subjekte të tjera nga sektori privat dhe publik, me qëllim realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit. Veçanërisht të rëndësishme për këtë program studimi janë bashkëpunimet e sukseshme me institucionet financiare, Raifeisen, Union Bank, Sigal etj. në funksion të realizimit të praktike mësimore dhe profesionale nga studentët.. <i>[22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	GVJ konstatoi, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, se UMT ka vendosur dhe zbaton marrëdhënie zyrtare bashkëpunimi, në funksion të kryerjes me efektivitet të praktikave mësimore. <i>[22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	GVJ, në përfundim të analizës së dokumentacionit dhe takimeve direkte në institucion, fomuloi vlerësimin, se UMT garanton bashkëpunim real me institucione homologe, në funksion të realizimit të objektivave lidhur me kërkimin shkencor në programin e studimit. Nga tërësia e marrëveshjeve në kuadrin e programit Erasmus+, 16 prej tyre janë në funksion të programit të shqyrtuar, dhe janë vënë në veprim shkëmbimet për stafin dhe studentët, psh. me Universitetin Masaryk Çeki, Universitetin e Lodzit Poloni etj. <i>[27.UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimitmobilitetit.pdf]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	GVJ, në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për programin e studimit, verifikoi, se Departamenti i Shkencave Administrative harton raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Ato analizohen më tej nga Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë dhe Rektorati i UMT, duke parë me prioritet thellimin e bashkëpunimit me universitete nga vende si Italia, Polonia, Çekia, Rumania etj. që ofrojnë më shumë vlerë për programin e shqyrtuar.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

	[73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësues, kërkimor dhe financiar_FE.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.6

**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstatoi se UMT, bazuar në statutin dhe planin zhvillimor mbështet çdo inisjativë për pjesëmarrje të stafit akademik dhe studentëve të programit të studimit në projekte kërkimi shkencor, që përfundojnë me publikime. Disa prej tyre gjenden të botuara në revistën shkencore të UMT. Gjithashtu, një rol aktiv në plotësimin e këtij kriteri luan edhe inkubatori Metro research me aktivitetin e tij në rritje. [24.UMT_Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe realizimit të takimeve në institucion, verifikoi se Fakulteti i Ekonomisë UMT ia ngarkuar pozicionit të Zv. Dekanit kopetencat për mbikqyrjen e procesit dhe rezultateve të kërkimit shkencor. [2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	GVJ, si nga analiza e dokumentacionit, ashtu edhe nga trakimet me stafin, drejtuesit dhe studentët, arriti në përfundimin, se UMT ka vendosur përcaktime në rregulloren e universitetit dhe atë të Fakultetit të Ekonomisë, duke filluar nga nenet që formulojnë vizionin dhe mision, e në vazhdim për promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor. Këto përcaktime janë materializuar me organizimin e një serie aktivitesh, ndër të tjera 3 konferenca studentore dhe botimet në revistën shkencore të UMT. [2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf]
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve në institucion, GVJ krijoi gjykimin, se UMT ka hartuar dhe zbaton një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe shmangien e plagjiarizmit në botimet e kërkimve shkencore që lidhen me programin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	studimit. [92. FE_Keshilli Bordi Shkencor.pdf, 93.FE_Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik të FE.pdf]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Pas takimeve në institucion me stafin dhe studentët, si dhe shqyrtimin e dokumentacionit, GVJ krijoi vlerësimin se UMT i përkrah inicjativat individuale për kërkim shkencor duke ofruar një mjedis favorizues, element i të cilit është edhe revista shkencore e UMT, apo mbështetja konkrete për aplikime për pjesëmarrje në projekte kërkimore-shkencore. [93.FE_Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik të FE.pdf, 94.FE_Aplikimet për kërkim shkencor, email për thirrjet.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHEKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, bazuar në Ligjin 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe sistemin ECTS, me lëndë dhe module të vlerësuara me kredite. Numri total i krediteve është 120 dhe kohëzgjatja 2 vjet. [55. FE_Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E) (Tabela Nr. 9).pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	GVJ, pas analizimit të dokumentacionit në dispozicion, vlerëson se programi i studimit ka formuluar synime të qarta për formimin e aftësive dhe shprehive të veçanta në një llojshmëri profesionesh brenda fushës së administrimit, si tipar dallues i MBA-së. I diplomuari në këtë program

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

14

	<p>mund të punojë në nivel drejtues në kompani biznesi, në sektorin financiar, në aktivitete prodhuese, shërbimesh, por edhe në administratën publike, aty ku nevojiten kopetenca për menaxhimin e partneritetit publik privat.</p> <p><i>[54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ, duke shqyrtuar dokumentacionin në dispozicion, arriti në përfundimin se programi i studimit jep njohuri të avancuara, në fushën e ekonomisë dhe administrimit, që përfshijnë aftësitë menaxheriale, lidërshpin, menaxhimin e cilësisë, menaxhimin e projekteve, kontabilitetin menaxherial, etikën etj. dhe ka mbajtur parasysh specifikat e kuptimit kritik të teorive shkencore, duke iu krijuar studentëve një bazë të mirë për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve.</p> <p><i>[53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin, krijoi gjykimin se programi i studimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që të transmetojë njohuri të avancuara në fushën e ekonomisë dhe administrimit, që lejojnë zgjidhjen e problemeve komplekse (menaxheriale – financiare) me të cilat ndeshet biznesi privat, për ndërmarrjen e investimeve të reja, modernizimin e aktivitetit në kushtet një mjedisi në ndryshim të shpejtë apo administrata publike për zbatimin e reformave të kërkuara në kuadrin e integritimit me BE.</p> <p><i>[55. FE_Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E) (Tabela Nr. 9).pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, konstatoi se programi i studimit i përmban të gjithë elementët e strukturës së përcaktuar nga aktet ligjore në fuqi, lidhur me tipologjinë e lëndëve, sasinë e krediteve dhe shpërdarjen e tyre, praktikën mësimore dhe mikrotezën e diplomës.</p> <p><i>[54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, GVJ verifikoi, se në programin e studimit janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, dhe është kryer kategorizimi i duhur i tipit A – E, me ngarkesat përkatëse në kredite: lëndë bazë A 10%, lëndë karakterizuese B (52%), lëndë ndërdisiplinore integruese C (18%), lëndë plotësuese D (10%) dhe detyrimet përmbyllëse E (15%).</p> <p><i>[55. FE_Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E) (Tabela Nr. 9).pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, gjen se në programin e studimit është parashikuar realizimi dhe mbrojtja e temës së diplomës me 18</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



15

kuadër të zhvillimit të saj	kredite, si një punim kërkimor-shkencor, pasi janë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara nga rregullorja (provime, praktika mësimore), si dhe është marrë miratimi i udhëheqësit. <i>[53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ, bazuar ne dokumentacion vlerëson se njësia bazë Fakulteti i Ekonomisë UMT i përbërë nga 3 departamente, plotëson detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Po ashtu, Departamenti i Shkencave të Administrimit brenda këtij fakulteti plotëson kriteret numrit të stafit akademik me tituj e grada në programin e studimit. <i>[66.FE_Lista e plotë e personelit akademik me kohe të plotë, me kohë të pjesshme_FE_Tab.Nr.2.pdf]</i>



<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur, vlerëson se Departamenti i Shkencave Administrative për vitin akademik 2020-2021, raporti PAE/PAK rezultoi 8/19. Në përberje të PAE kemi (1 Prof Dr, 1 Prof As., 3 Dr, 3 Msc) ndërsa PAK (4 Prof Dr, 4 Prof As., 9 Dr, 2 Msc). Departamenti respekton kuadrin ligjor për sa i përket numrit të personelit akademik që duhet për departamentin.</p> <p><i>[66.FE_Lista e plotë e personelit akademik me kohë të plotë, me kohë të pjesshme_FE_Tab.Nr.2.pdf</i></p> <p><i>68.FE_Të dhëna statistikore të personelit akademik PAE_PAK_Tab.Nr.1.pdf].</i></p> <p><i>[57.FE_Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies_Tabela nr.4.pdf]</i></p> <p><i>[57.FE_Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies_Tabela nr.4.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>GVJ, bazuar në përgjigjet e drejtuesve të Fakultetit të Ekonomisë UMT dhe Departamentit të Shkencave Administrative mësoi se është angazhuar personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, lidhur me programe kompjuterike (softe) në programin e studimit, por pa specifikuar numrin e tyre.GVJ nuk konstatoi ndonjë dokument zyrtar për ta konfirmuar këtë fakt.</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësies përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur, vlerëson se Fakulteti i Ekonomisë UMT dhe Departamenti i Shkencave Administrative kanë hartuar përshkrimin e punës për pozicionin e përgjegjës të programit të studimit, por nuk na rezulton që ky pozicion të jetë plotësuar. Në gjykimin e GVJ, këto detyra kryhen nga Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Administrative.</p> <p><i>[57.FE_Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies_Tabela nr. 4.pdf, 39.UMT_ Pershkrimin e punes të përgjegjës të programit të studimit.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, dhe takimet në institucion, vlerëson se Fakulteti i Ekonomisë UMT dhe Departamenti i Shkencave Administrative kanë krijuar stukturat e duhura që gjenerojnë dhe shkëmbejnë informacione, si dhe zotërojnë ekspertizë të kënaqshme lidur me zbatimin efektiv të programit të studimit.</p> <p><i>[53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf - 61.FE_CV_Personeli Akademik_FE.pdf]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, konstaton, se programi i studimit është organizuar në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese, sipas normave ligjore në fuqi, si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lëndë bazë A, 6 kredite</li> <li>- lëndë formuese B, 62 kredite</li> <li>- lëndë ndërdisiplinore/integruese C, 22 kredite</li> <li>- lëndë plotësuese D, 12 kredite</li> <li>- detyrime përmbyllëse (teza e diplomës) E, 8 kredite.</li> </ul> <p>[55.FE_Plani mësimor sipas llojit të veprimitarisë (A-E) (Tabela Nr. 9).pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, konstaton, se programi i studimit përmban planin mësimor, ku janë detajuar informacionet e nevojshme mbi ngarkesën mësimore, me 300-330 orë në semstër në auditor (rreth 25% e totalit) dhe 420-450 orë në semstër jashtë auditorit (rreth 25% e totalit) për studim individual, duke realizuar shpërndarje të njëtrajsme të ngarkesës përgjatë të katër semestrave, në dy vite studimi gjithsej. <i>Nevojitet që orët e parashikuara për studim individual të shënohen edhe në syllabusat e lëndëve të veçanta.</i></p> <p>Kërkesat mbi frekuentimin e programit janë specifikuar në çdo syllabus të lëndëve dhe kërkojnë pjesëmarrje në të paktën e 70% të orëve teorike dhe praktike. Mënyra e vlerësimit të dijeve, gjithashtu përmbahet në çdo syllabus dhe kombinon vlerësimin e vazhdueshëm gjatë semestrit me 30-50% të pikëve totale, me vlerësimin përfundimtar me provim, 50-70% e pikëve totale.</p> <p>[54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, konstaton, se programi i studimit përmban informacione mbi kriteret e pranimit, të transferimit apo ekuivalentimit të studimeve, në nenet 23, 24 dhe 25 të Rregullores së programit të studimit MBA.</p> <p>[53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 58.FE_Rregullore e programit.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, konstaton, se në planin mësimor të programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përmbahen të dhëna të detajuara mbi: emërtimet dhe grupimet e moduleve në semestra, numrin e orëve dhe krediteve për çdo modul (të specifikuar sipas leksioneve, seminareve, detyrave të kursit dhe laboratorëve, detyrimet sipas moduleve dhe mënyrat e kontrollit të dijeve.</p> <p>[56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion, konstaton, se në programin e shqyrtuar të studimit nuk janë kryer ndryshime, krahasuar me planin mësimor, mbi të cilin është bazuar licensimi i programit . Departamaneti përgjegjës për programin ka iniciuar një</p>

dosja e plotë në shqip dhe anglisht	proces diskutimi mbi ndryshime dhe përmirësime të mundshme, bazuar në një format specifik, të hartuar për këtë qëllim nga UMT. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf, 42.UMT_Shembull Plan per rishikimin e programeve mesimore.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se ngarkesa e programit të studimit është në përputhje me VKM nr. 41dt. 24.01.2018 e ndryshuar, duke u shtrirë në dy vite akademike, me 2 semestra secili, me 120 kredite ECTS, ku studenti angazhohet në 20 orë mësimore në javë në auditor (4 orë në ditë), dhe ora mësimore zgjat 50 minuta. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se lëndët me natyrë strategjike, të tilla si: Strategji biznesi e avancuar, Strategji e operacioneve, Strategji marketingu, Drejtim financiar i avancuar dhe veçanërisht lënda Metoda kërkimi, mundësojnë avancim të njohurive dhe aftësive në ciklin e tretë të studimit, apo në vendin e ardhshëm të punës. [53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se lëndët, modulet, shpërndarja e tyre përgjatë viteve akademike, vlerësimi në kredite, bazuar në orët mësimore, ku rreth 300 orë në semestër zhvillohen në auditor, ndërsa 450 orë në semestër janë parashikuar për studim individual, bëjnë të mundur realizimin e objektivave formuese të programit të studimit, përvetësimin e njohurive dhe ndërmarrjen e kërkimit shkencor. Zhvillimi i tre konferencave studentore dhe aktiviteti i inkubatorit të biznesit, përbëjnë tregues të efektivitetit të këtij programi. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se struktura e programit të studimit, me 120 kredite ECTS, 3000 orë studimi brenda dhe jashtë auditorit, me raport të përshtatshëm teori-

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

20

<p>praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>praktikë, është në përputhje me profilin e shkencave ekonomike dhe administrative dhe programe të ngjashme ndërkombëtare, që zhvillohen në universitetet me të cilat UMT mban kontakte, veçanërisht me UPEC Francë. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se klasifikimi sipas veprimtarive formuese A-E dhe raporti teori-praktikë bëjnë të mundur realizimin e objektivave formues, transferimin e studimeve dhe punësimin brenda profilit. UMT merr fidbek konstant në funksion të realizimit efektv të këtij kriteri, duke ndjekur nga afër progresin në karrierë të të diplomuarve të tij, përfshirë edhe ata të këtij programi studimi. [81.Lista e studenteve Alumni.pdf, 82.FE_Rrjeti Alumni UMT.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se syllabuset e lëndëve të programit të studimit përgjithësisht përmbajnë literaturë të detyruar dhe ndihmëse, të botuar gjatë 5 viteve të fundit, por nevojitet përditësimi në lëndën Strategji marketingu dhe Etika në biznes. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se nga ky programi studimi studenti mund të përvetësojë dije të avancuara ndërdisiplinore, dhe aftësi e kopetenca “të forta” (hard skills) në fushat e menaxhimit, marketingut, sistemeve të informacionit, kontabilitetit menaxherial dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me ato “të buta” (soft skills) në lëndët Etikë biznesi dhe Aftësi menaxheriale. Ky kombinim është shumë i përshtatshëm për një program MBA të ciklit të dytë. [60.FE_Suplement i diplomës.pdf, 85.FE_Format pyetësori studenti.pdf ]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se përmbajtja e programit të studimit bën të mundur vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë, kryesisht në drejtimet e lidhura me menaxhimin dhe marketingun, por edhe me fushën e tregëtisë/marrdhënieve ndërkombëtare. Shifrat nga punësimi i të diplomuarve janë gjithashtu të kënaqshme, psh. në vitin akademik 2018-2019 rreth 67%. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf, 81.Lista e studenteve Alumni.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, strukturat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

21

<p>kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>përgjegjëse të Fakultetit të Ekonomisë UMT konsultohen dhe marrin parasysh propozimet që vijnë nga aktorë të tregut të punës, por kjo nuk kryhet në mënyrë të formalizuar dhe të dokumentuar. Fidbeku ka natyrë informale, gjatë takimeve që përfaqësues të UMT kryejnë me subjektet partnere nga fusha e biznesit dhe administrimit publik.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se në programin e studimit, kombinimi i formimit teorik me aktivitete praktike shkencore, ku si shembull mund të përmendim tre konferencat shkencore studentore, i shërbejnë vazhdimit eventual të studimeve në ciklin e tretë nga studentët që kanë performancën më të lartë dhe ambicjet shkencore për tu thelluar më tej në studimet e projektet e tyre kërkimore. [100.FE_Lista e Konferencave shkencore.pdf]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b> <b>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen për realizimin e programit të studimit, plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga Ligji 80/2015, në nenet 57, 59, 64 dhe 65. Gjithashtu ky personel plotëson edhe kërkesat e vendosura në Rregulloren e UMT në nenet 10, 11 dhe 12. [1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen për realizimin e programit të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, me titujt dhe gradat e kërkuara nga normat ligjore në fuqi, për drejtimin e lëndëve të programit. Janë angazhuar gjithsej 20 pedagogë, 8 PAE (2 Prof Dr, 6 Dr) dhe 9 PAK (2 Prof Dr, 2 Prof As., 5 Dr). Sipas perlllogaritjes se oreve mesimore, raporti PAE/PAK është respektivisht 70%-30% të mbulimit të orëve, pra e plotëson kriterin ligjor që ngarkesa mesimore për programin e mesimit duhet të mbulohet 70 % nga PAE.</p>

	[57.FE_Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies_Tabela nr. 4.pdf]			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur vlerëson, se fushat akademike kërkimore të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë të bëjnë ngushtësisht me menaxhimin e biznesit, si psh, në menaxhim strategjik, menaxhim shpërblimi, strategji marketingu, kontabilitet menaxerial, etikë biznesi, aftësi menaxheriale etj. Fushat e sipërpërmendura dhe të tjerat, që ndodhen në CV respektive të pjesëtarëve të stafit, janë në përputhje me natyrën e programit të studimit MBA. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf, 61.FE_CV_Personeli Akademik_FE.pdf]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, UMT nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjekte të tjera të sektorit privat dhe publik, tërheq individë të kualifikuar në fushat e tyre të ekspertizës, me qëllim mbiqyrjen e studentëve për praktikën mësimore dhe temën e diplomës. [23.UMT_Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FE.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, UMT angazhon personel ndihmës shkencor, kryesisht me kualifikim informatik, për mbarëvajtjen orëve me natyrë laboratorike (programim softesh). [67.FE_Lista e plotë e personelit ndihmës akademik dhe administrativ.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, strukturat përgjegjëse të UMT kërkojnë konsulencë nga tregu i punës dhe trajtojnë atë me seriozitet, por kjo kryhet jo në mënyrë të formalizuar dhe të dokumentuar. Fidbeku është i natyrës joformale dhe përftoet gjatë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

23

bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	takimeve që përfaqësues të UMT kanë me subjektet partnere nga sektori i biznesit dhe administrata publike. [22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf, 82.FE_Rrjeti Alumni UMT.pdf]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, UMT inkurajon dhe krijon mundësi për përfshirje në diskutime (edhe të studentëve të programit MBA) nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Senatën e UMT nga presidenti i qeverisë studentore. Lidhur me përmbajtjen e këtij programi studimi, fidebaku me natyrë përmirësimi nga studentët konstatohet të jetë më tepër informal, ndërkohë që fidebaku i tyre lidhur me performancën e pedagogëve është i formalizuar nëpërmjet një pyetsori. [12.UMT Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf, 105.FE_Rregullore e Senatit Studentor UMT.pdf]			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, UMT mban kontakte me alumnit nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe merr fidebek, por me natyrë joformale, prej tyre lidhur me përmirësimet të mundshme të programit. Vlen të përmendet takimi i rregullt vjetor me të diplomuarit, në muajin maj të çdo viti, si një premisë drejt formalizimit të këtij procesi. [51.FE_StrukturaOrganigrama e FE.pdf, 82.FE_Rrjeti Alumni UMT.pdf]			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se për këtë program mësimor, UMT mban kontakte me subjekte të tjera kërkimore shkencore, dhe administratët publike për marrje fidebaku përmirësues. [22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf, 23.UMT_Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FE.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.7

### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke i sintetizuar në formulimin “e përgatitjes së liderëve të mendimit dhe veprimt”, duke nënvizuar dhe shtjelluar me detaje në objektivat e përgjithshëm dhe specifike të programit. Këto formulime përkojnë me nenin 1 dhe 4 të Statutit të UMT, që sanksionojnë respektivisht natyrën

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

24



	<p>akademike të institucionit dhe misionin e tij lidhur me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, si dhe me frymën e planit strategjik të zhvillimit të UMT.</p> <p><i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 3.UMT_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Shkencave Administrative në UMT, e respekton lirinë akademike të personelit të angazhuar. Kjo konstatohet nga analiza e përmbajtjes së syllabusave, ku ka larmi në kombinimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive dhe lirshmëri në përzgjedjen e literaturës bazë dhe ndihmëse. Po ashtu, larmia në përzgjedhjen e temave të mikrotezave të diplomave, reflekton respektimin e interesave shkencore, të harmonizuara mes pedagogëve dhe studentëve.</p> <p><i>[56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf, 91.FE_Lista e Studentëve_tema e diplomes_udheheqes_.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se UMT në këtë program studimi favorizon angazhimin e studentëve në punë individuale kërkimore, që është materializuar me pjesëmarrjen e tyre në tre konferenca shkencore studentore dhe leksione të hapura me lektorë të huaj, që shërben si nxitje shtesë për ide të reja kërkimore.</p> <p><i>[72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf, 100.FE_Lista e Konferencave shkencore.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se programi i studimit është pjesë e procesit studimor dhe kërkimor-shkencor, por nuk konstatoi lidhje konkrete me zbatimin e ndonjë politikee studimore në nivel kombëtar apo rajonal.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Shkencave Administrative, nxisin stafin dhe studentet të aplikojnë për grante dhe financime të projekteve të tyre kërkimore-shkencore, por nuk konstatohet ndonjë financim i drejtpërdrejtë nga UMT për këtë qëllim.</p> <p><i>[27.UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkembimitmobilitetit.pdf, 86.FE_Donacionet nga projektet për laboratorët.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

## Standardi II.8

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

25

**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>								
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se UMT ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucione shkencore/universitete, brenda dhe jashtë vendit, si dhe nxit stafin dhe grupet e lëndëve për të krijuar kontakte dhe aplikuar për pjesëmarrje në projekte kërkimore, në funksion të realizimit të objektivave të këtij programi mësimor. Duhet theksuar pjesëmarrja në projektet fituese SMART4ALL dhe METRIC, si element mjaft pozitiv në plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>[22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf, [24.UMT_Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf]]</i></p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se Fakulteti i Ekonomisë UMT angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut për studime me natyrë kërkimore, ku angazhohet stafi akademik dhe studentët e programit.</p> <p><i>[24.UMT_Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf]</i></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se Fakulteti i Ekonomisë UMT, në funksion të programit të studimit ka organizuar tre konferenca shkencore studentore, dhe një shkollë verore për sipërmarrjen dhe inovacionin, që konkretizojnë punën kërkimore të stafit akademik dhe studentëve të programit.</p> <p><i>[100.FE_Lista e Konferencave shkencore.pdf]</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT ka hartuar udhëzues për metodat inovative të mësimdhënies. Aty shtjellohen shkurtimisht metodat e mësimit nëpërmjet hetimit, mësimi të bazuar në projekte, përdorimi i teknologjisë (psh. në rastin e marketingut dixhital) dhe mësimi nëpërmjet pjesëve të një enigme.</p> <p><i>[102.FE_Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, Fakulteti i Ekonomisë UMT ka krijuar mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Administrative ka rol kryesor në këtë proces, dhe në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kanë organizuar dhe zbatuar procesin e kontrollit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet vlerësimit të mësimdhënies në auditor, vlerësimit të pedagogut nga studentët, si dhe marrjen e opinionëve të studentëve në takime direkte individuale, apo nëpërmjet përfaqësuesve të qeverisë studentore.</p> <p><i>[10.UMT_Analizë e NJSBC për pyetëtorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf, 113. FE_Formular dhe Proçes verbal i kontrollit ne auditor nga Departamenti.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, nëpërmjet pyetësorit semestral për lëndën dhe pedagogun, përpara zhvillimit të provimit përfundimtar të lëndës. Ankesat lidhur me vlerësimin e studentit nga pedagogu trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e provimeve, në instancat e hierarkisë, deri në nivel Dekani.</p> <p><i>[101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf, 113. FE_Formular dhe Proçes verbal i kontrollit ne auditor nga Departamenti.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, NJSBC kryen periodikisht publikimin e rezultateve të vlerësimit, nëpërmjet Raportit vjetor të UMT, i cili i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

27

	<p>Rinisë, si dhe publikohet në faqen e internetit të institucionit. Aktualisht, në faqe ndodhet i publikuar Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.</p> <p><i>[10.UMT_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf, 73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar_FE.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT promovon ndarjen e praktikave më të mira, që identifikohen në procesin e vlerësimit të performancës në mësimdhënie, nëpërmjet seminareve/trajnimeve për mënyrën e zhvillimit të leksioneve, por nuk ka një evidencë të qartë si kanë ndikuar ato në përmirësimin e mësimdhënies në programin e shqyrtuar.</p> <p><i>[76.FE_Minuta të mbledhjeve të dekanatit.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

### Standardi III.2

#### Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT ka përcaktuar leksionet (mesatarisht 40-50% e lëndës), seminarët (mesatarisht 40-50% e lëndës), detyrat e kursit (5-10% e lëndës), projektet (5-10% e lëndës), praktika mësimore (rreth 27% e totalit të orëve të programit të studimit) etj. si forma të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>[2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 53.FE_Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit.pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në situatën e pandemisë së Covid-19, stafi akademik i UMT përshtati metodat e mësimdhënies, duke vënë në përdorim ato on-line, nëpërmjet moduleve GotoMeeting dhe edu4school. Në vazhdim, u mor opinioni i studentëve mbi këto metoda, me qëllim vlerësimin e kënaqësisë së studentëve dhe efektivitetit të procesit.</p> <p><i>19. UMT_Pyetesor mbi zhvillimin e mesimit online.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

28

<p>përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT e mbështet mbështet stafin akademik në drejtim të rritjes së kualifikimeve profesionale, duke nxitur pjesëmarrjen në programin Erasmus+, me qëllim trajnimi në universitetet partnere, por bazuar në informacionin e disponueshëm nuk mund të vlerësohet me saktësi si kanë ndikuar ato në programin e shqyrtuar. [25.UMT_Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik ne kuader te erasmus+.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e CV të personelit akademik të angazhuar në program dhe takimet në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik i UMT i zotëron kopetencat e nevojshme për transmetimin e dijeve bashkëkohore te studentët, nëpërmjet përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Disa prej lektorëve të programit kanë sjellë një përvojë të pasur nga puna në FE UT, si psh. Prof. Dr. A. Ceni, Prof. Asoc. Dr. A. Qefalia etj. Në veçati vlen të përmendet vlera e shtuar e sjellë nga lektorët e huaj pjesë e këtij programi, Dr. Kakouris në strategjitë e avancuara të biznesit dhe Dr. Karagianis në strategjitë e marketingut. [61.FE_CV_Personeli Akademik_FE.pdf, 72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Administrative në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kanë organizuar dhe zbatuar procesin e kontrollit të vazhdueshëm të formave dhe metodave të mësimdhënies, ndër të tjera, nëpërmjet vlerësimit të pedagogut nga studentët, si dhe marrjen e opinionëve të studentëve në takime direkte individuale, apo nëpërmjet përfaqësuesve të qeverisë studentore. [10.UMT_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, me stafin dhe studentët, arriti në përfundimin, se në këtë program mësimor, përdoren metodat interaktive, bashkëkohore të mësimdhënies, të tilla si metodat e mësimi nëpërmjet hetimit, mësimi të bazuar në projekte, përdorimi i teknologjisë (psh. në rastin e marketingut dixhital) dhe mësimi nëpërmjet pjesëve të një enigme etj. [102.FE_Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhëniesve të respektit</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, veçanërisht në prononcimet e studentëve, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik i UMT inkurajon punën e pavarur të studentit, në formë përgatitje detyrash kursi, prezantimesh, rastesh studimore e projektsh, duke ju ofruar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

29

të ndërsjellë mes tyre	asistencë, kur është e nevojshme. Sipas prononcimeve të studentëve, këto metoda përdoren si nga lektorët e huaj, ashtu edhe ata vendas, në lëndë të tilla si strategji marketingu, strategji e avancuar biznesi, etikë biznesi, aftësi menaxheriale etj. [102.FE_Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT ofron 2 godina të lokalizuara pranë Qytetit Studenti, në rrugën Budi. Godina 1 ka sipërfaqe të shfytëzueshme 2347 m2, me 9 salla seminari, secila me kapacitet për 50 studentë; 4 salla leksioni, secila me kapacitet për 100 studentë dhe 2 laboratorë. Në këtë godinë gjendet edhe biblioteka. Godina 2 ka sipërfaqe të shfytëzueshme 2490 m2, me 8 salla seminari me kapacitet për 40 studentë secila, 4 salla leksioni me kapacitet për 100 studentë secila dhe 4 laboratorë. Të gjitha ambientet janë të pajisura me sistem ngrohjeje, edhe në korridore. GVJ konstatoi nivel të kënaqshëm mirëmbajtje dhe pastërtie. [108.FE_Asete infrastrukturore akademike_UMT.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT ofron mjedise funksionale, ku çdo sallë është e pajisur me kompjuter (desktop), me videoprojektor dhe lidhje interneti ËIFI, gjë që lehtëson mbarëvajtjen e procesit mësimor, përfshirë edhe praktikat. ku nevojitet përdorimi i materialeve të dixhitalizura (në format slajdesh PoëerPoint etj.) si dhe ndërveprimi elektronik në kohë reale. [107.FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik dhe studentët e UMT, kanë në dispozicion në total 6 laboratorë kompjuterikë, ku mundësohet zëvillimi i lëndëve të lidhura me informatikën dhe sistemet e informacionit. UMT mundëson komunikimin elektronik pedagog-student, nëpërmjet platformave të specializuara on-line, siç është edu4school (e dedikuar për menaxhimin e procesit didaktik dhe administrativ) dhe GotoMeeting (për zhvillimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

30

	<p>mësimin online). Laboratorët mundësojnë gjithastu përdorimin edhe të mjeteve të tjera periferike të komunikimit elektronik (smartphone, laptopë, tablete etj.)</p> <p>[43.UMT_Sistemi_informatik_i_menaxhimit_te_studenteve.pdf 45.UMT_Ndërfaqja (Administratori, Pedagogu, Sekretaria, Studenti).pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program studimi në UMT, studentëve iu vihet në dispozicion literaturë bazë dhe ndihmëse, e mjaftueshme dhe e disponueshme për të gjithë studentët, në gjuhën shqipe, si psh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A. Koxhaj, Aftësitë Menaxheriale, 2016</li> <li>- A. Ceni, Menaximi i Shpërblimit, 2018</li> <li>- S.Panariti, Menaxhim Projekti, 2017</li> </ul> <p>[109.FE_Relacion biblioteken (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike_UMT-FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se biblioteka përmban gjithsej 758 tituj, nga të cilët, për këtë program studimi, studentëve iu vihet në dispozicion një numër i kënaqshëm botimesh të viteve të fundit, ndërsa hapësira fizike e bibliotekës rezulton e pamjaftueshme, me pak vende për tu ulur, duke patur parasysh numrin e studentëve të UMT në total.</p> <p>[109.FE_Relacion biblioteken (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike_UMT-FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik dhe studentët e UMT aksesojnë librari online pa pagesë, me literaturë për fushën e tyre të studimit, si psh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <a href="http://ëëë.thefreelibrary.com">http://ëëë.thefreelibrary.com</a></li> <li>- <a href="http://ëëë.doj.org">http://ëëë.doj.org</a></li> <li>- <a href="http://ëëë.gutenberg.org">http://ëëë.gutenberg.org</a> etj.</li> </ul> <p>[109.FE_Relacion biblioteken (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike_UMT-FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program studimi në UMT, studentëve iu vihet në dispozicion sallë kompjuterike për nevoja të përgatitjet së detyrave të kursit, diplomave etj.</p> <p>[107.FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik dhe studentët e UMT aksesojnë platforma online të mësimdhënies si psh. GotoMeeting. Kjo platformë u vendos në përdorim në kushte emergjence, pas nisjes së pandemisë Covid-19, në mars 2020, duke u përdorur në mënyrë efektive për të gjitha lëndët e programit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

31

	Trajnimi i përdoruesve për funksionet bazë u krye me sukses brenda një kohe të shkurtër disaditore dhe gjatë javëve që pasuan për funksionet e tjera plotësuese. [117.Rregullore mbi menyren e zhvillimit te provimeve On-line.pdf]			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik dhe studentët e UMT aksesojnë një platformë të brendshme të komunikimit, me dokumentacion elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar, e emërtuar edu4school, ku gjenden të gjitha dokumentat e dixhitalizuara që lidhen me programin mësimor, syllabuset, orarin mësimor, detyrimet e studentëve dhe progresin e tyre akademik etj. Gjatë pandemisë Covid-19 u vu në përdorim paralelisht edhe platforma e mësimdhënies on-line GotoMeeting. Këto platforma aksesohen nga adresat zyrtare të emailit <a href="mailto:emer.mbiemer@umt.edu.al">emer.mbiemer@umt.edu.al</a> , që janë krijuar nga UMT për çdo student dhe pedagog. [117.Rregullore mbi menyren e zhvillimit te provimeve On-line.pdf]			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, stafi akademik i UMT i orienton studentët paraprakisht në përfundim të semestrit të parë të vitit të dytë të studimeve, duke i njohur me procedurën dhe temat e mundsme të diplomave. Studenti e përzgjedh udhëheqesin nga lista e stafit akademik të disponueshëm, duke mbajtur parasysh në mënyrë të ndërsjelltë interesat kërkimore. Studentët u shprehën të kënaqur nga procesi i orinetimit dhe asistencës nga ana e udhëheqësve të temave të tyre të diplomës, jo vetëm nga pikëpamja metodike, por edhe për ndihmën në përpunimin e gjetjeve dhe diskutimin e tyre, formulimin e konkluzioneve etj. [65.FE_Plan pune për punimin e diplomës_Msc ne MBA.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b> <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, vlerëson, se në nivel institucional, përfshirë edhe këtë program studimi, UMT bazuar në nenet 29-30 të Statutit me vendimin të Senatit Akademik të vitit 2019 ka miratuar strukturën dhe përbërjen (me 6 anëtarë) të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), që monitoron, kontrollon dhe promovon përmirësimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

32



	vazhdueshëm të mësimdhënies në koordinim me departamentet e secilit fakultet dhe zyrën e cilësisë dhe kurrikulave. <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf, 7.UMT_VSA për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Shkencave Administrative, në UMT, janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e ndërgjegjësimit të stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit. <i>[2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur, arriti në përfundimin se strukturat dhe njësitë përgjegjëse për programin e studimit në UMT, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, të tilla si metodat e mësimi nëpërmjet hetimit, mësimi të bazuar në projekte, përdorimi i teknologjisë (psh. në rastin e marketingut dixhital) dhe mësimi nëpërmjet pjesëve të një enigme. <i>[102.FE_Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT e nxit stafin akademik dhe atë mbështetës, që të shfytëzojnë çdo mundësi gjatë shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve me institucionet partnere, për kualifikim të mëtejshëm, lidhur me metodat e kërkimit shkencor, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies, por mungon një evidencë e saktë lidhur me numrin dhe natyrën e këtyre kualifikimeve. <i>[22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf, 27.UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimitmobilitetit.pdf]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT e nxit stafin akademik, që të shfytëzojnë çdo mundësi gjatë shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve me institucionet partnere, për trajnime, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies, por mungon një evidencë e saktë lidhur me numrin dhe natyrën e këtyre trajnimeve. <i>[22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf, 27.UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimitmobilitetit.pdf]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT, stafi akademik dhe ai mbështetës janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe përmirësimin e tij.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

33

implementimin e metodave të reja.	[2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf]			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT, stafi akademik dhe ai mbështetës raportojnë periodikisht tek drejtuesit e tyre, në mënyrë jorormale, mbi risitë në mësimdhënie, bazuar në analiza joformale të efekteve dhe pritshmërive. Nga ana tjetër, formalizimi i sintezës së këtyre raportimeve realizohet vetëm në raportin vjetor të institucionit. [73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar_FE.pdf]			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT angazhon lektorë dhe kërkues shkencorë, vendas dhe të huaj, si psh. Prof. Dr. Andri Koxhaj në fushën e aftësive menaxeriale, Prof. Asoc. Dr. Arjan Qefalia në fushën e menaxhimit të cilësisë, Dr. Kakouris në fushën e strategjive të avancuara të biznesit dhe Dr. Karagianis në fushën e strategjive të marketingut etj., në funksion të shkëmbimit të ideve dhe metodave mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Nga evidenca e të gjithave aktiviteteve me lektorë të huaj, është e vështirë të saktësohet përfitimi konkret për programin e shqyrtuar, lidhur me këtë kriter. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf, 72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT janë hartuar rregullore që përcaktojnë kriteret dhe mënyrat e testimit të njohurive, dijeve, dhe aftësive. Të gjitha këto informacione, ndodhen në syllabuset e lëndëve të programit, të cilat studenti mund ti aksesojë lehtësisht nëpërmjet platformës edu4school, si dhe nëpërmjet pedagogut të lëndës, i cili mund të japë sqarime më të detajuara për çdo rubrikë të vlerësimit. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

34

metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	UMT, studentët informohen që në fillim të lëndës mbi mënyrat dhe metodat e vlerësimit të njohurive, siç janë përcaktuar në syllabuse. [101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT, testimi i njohurive kryhet nëpërmjet kombinimit të metodave të ndryshme. Në përbërje të vlerësimit hyjnë dy rubrika kryesore: pikët nga semestri, ku vlerësohen pjesëmarrja aktive në seminare, testimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, projektet etj., dhe pikët nga provimi final. [101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT, testimi i njohurive kryhet në vazhdimësi gjatë gjithë vitit akademik. Vlerësimi përfundimtar përmban dy rubrika kryesore: pikët nga semestri, ku vlerësohen pjesëmarrja aktive në seminare, testimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, projektet etj., me peshë 30-50% të totalit të pikëve; dhe pikët nga provimi final (50-70%) të totalit të pikëve. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf, 58.FE_Rregullore e programit.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT nuk ka përdorur sisteme elektronike të testimit. [101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT komisionet e provimeve krijohen me të paktën 2 anëtarë, ku njëri është titullari i lëndës. [63.FE_Procedura për zhvillimin e provimeve_FE.pdf]
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT provimi me shkrim zhvillohet me sekretim, me vendosje barkodi nga sekretaria mësimore. Pedagogu korrigjon tezën

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

35

me personel dhe/ose kamera sigurie.	anonime të provimit, llogarit dhe shpall notat sipas kodeve, më pas sekretaria mësimore realizon bashkimin e emrave me notat, sipas kodeve. <i>[63.FE_Procedura për zhvillimin e provimeve_FE.pdf]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT provimi shoqërohet me komente dhe fidbek, me karakter ndihmës për studentin. Ky fidbek ka natyrë verbale gjatë semestrit, ndërsa merr formë me shkrim në rastin e korrigjimit të testeve të ndërmjetme dhe provimeve përfundimtare (shënimet e pedagogut në tezë gjatë korrigjimit). <i>[63.FE_Procedura për zhvillimin e provimeve_FE.pdf]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT, strukturat përgjegjëse përdorin skanime elektronike të punimeve, për të shmangur plagjiaturën në formulimin e detyrave të kursit dhe projekteve, ndërsa ushtrojnë mbikqyrje rigorozë gjatë provimeve me shkrim për të evituar dhe parandaluar fenomenin e kopjimit nga studentët. <i>[14.UMT_Rregullore e Etikës.pdf, 63.FE_Procedura për zhvillimin e provimeve_FE.pdf 101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, në UMT, rezultatet e provimeve bazohen mbi performacën e studentit gjatë semestrit dhe në provimin final. Në rastin e provimit me gojë, rezultatet jepen menjëherë pas provimit, ndërsa për provimet me shkrim, notat paraprake shpallen brenda tre ditëve nga data e zhvillimit të provimit. <i>[101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT garanton me nenin 18 të rregullores së provimeve, të drejtën e studentëve për tu njohur me detajet e vlerësimit të tyre. Studenti njiet me notën në platformën edu4school dhe ka të drejtë të kërkojë rishikim brenda tre ditëve nga shpallja e notës paraprake. <i>[101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]</i>
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe takimeve në institucion, arriti në përfundimin, se për këtë program mësimor, UMT garanton shqyrtimin e ankesave me procedurë transparente, edhe me komision të posaçëm rishqyrtimi, nëse kërkoet nga studenti. Komisioni i ri caktohet nga Departamenti, me pedagogë të tjerë nga ata të komisionit fillestar të provimit. Ky komision kryen rivlerësimin dhe jep notën përfundimtare, e cila depozitohet me procesverbal në sekretarinë mësimore

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

36

	[101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që programi i studimit është zhvilluar në mënyrë të tillë, që kombinon përfitim të njohurive teorike në kombinim me ato të zbatimeve praktike, në fushën e menaxhimit të biznesit, në realitetin shqiptar, por edhe më gjerë, në kontekst ndërkombëtar. Vlerësojmë, se ky program me lëndët që përmban, praktikën mësimore dhe hartimin e mikrotezës, e favorizon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. [55.FE_Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E) (Tabela Nr. 9).pdf, ]
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë dhe IT, nëpërmjet lëndës së sistemeve informatike të menaxhimit; aftësi humane sociale, kryesisht nëpërmjet lëndëve aftësi menaxheriale, manaxhim shpërblimi, qeverisje korporatash; si dhe ato të komunikimit e ndërveprimit në lëndën strategji marketingu e etikë biznesi. Elementë të aftësive të mësipërme gjenden të inkuorpuara edhe në lëndet e tjera të programit. [54.FE_Plani mësimor (Tabela Nr.10).pdf, 56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që analiza dhe shqyrtimi i kopetencave dhe aftësive, që përfiton studenti në përfundim të lëndës, është një proces që kryhet në mënyrë jo të formalizuar, por verbalisht nga ana e pedagogëve në raport me studentët, duke u bazuar në performancën e tyre, në raport me aftësitë dhe kopetencat e përcaktuara në çdo syllabus. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, stafi akademik bën përpjekje që ti orientojë studentët dhe ti ndergjegjesojë ata për çështjet më thelbësore, në takime me të gjithë grupin, por edhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

37

	<p>në takime individuale. Konstatohet, se ky është një proces jo i formalizuar (me shkrim), por kryhet verbalisht.</p> <p>[56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, janë realizur orë të hapura mësimore, mbi çështje specifike të ekonomisë dhe biznesit, nga stafi akademik i brendshëm, i jashtëm, por edhe nga guest speaker nga jashtë vendit, me kualifikime të larta. Tema që ka patur më tepër interes për programin, ka qenë ajo mbi ndërtimin dhe implementimin e ekosistemeve nga Dr. Roundy dhe Dr. Lyon nga SHBA (janar 2021).</p> <p>[72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, mësimdhënia është realizuar mbi bazën e kopetencave që përftojnë studentët, në fusha të tilla, si: aftëstësi menaxheriale, menaxhim strategjik i avancuar, strategji marketingu e avancuar, kontabilitet menaxherial, menaxhim projekti, menaxhim cilësie etj., të cilat mund të konkretizohen lehtësisht gjatë praktikave profesionale në subjekte biznesi.</p> <p>[56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, stafi akademik përfshihet në diskutime dhe punë në ekip. Kjo është parashikuar në syllabusin e çdo lënde të programit dhe, bazuar në prononcimet e marra nga studentët dhe stafi, rezulton të jetë praktikuar efektivisht gjatë zhvillimit të programit.</p> <p>[56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, stafi akademik bën përpjekje për krijimin e një klime të favorshme ndaj risive dhe novacionit.</p> <p>[24.UMT_Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, UMT nxit zhvillimin e ideve novative, në fusha të ndryshme të biznesit, dhe bën përpjekje të organizojë financime në mbështetje të tyre, por nuk ka ndonjë evidencë specifike për ide novatore të studentëve të këtij programi.</p> <p>[15.Lista e startup dhe incubator.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin stafi akademik i UMT i kombinon format e mësimdhënies me subjekte bashkëpunuese, me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

38

mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	qëllim rritjen e mobilitetit. Në vitet 2018-2020 janë angazhuar në mobilitete 8 pedagogë dhe 19 studentë, <i>por mungon një evidencë specifike për programin në shqyrtim.</i> [28. UMT_Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi III.8

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, UMT ka hartuar procedurë të posaçme për mbrojtjen e diplomës, i cili iu bëhet studentëve i ditur para diplomimit. [64.FE_Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Msc ne MBA.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, strukturat përgjegjëse të UMT i kushtojnë kujdes asistimit të studentëve me materiale dhe informacione në funksion të mbrojtjes së diplomës. Roli kryesor në këtë proces është kryer nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili është siguruar që studentët ti marrin informacionet lidhur me diplomimin, nëpërmjet platformës edu4school, që në fillim të procesit të studimeve, por në fund të semestrit të parë të vitit të dytë të studimeve nis puna konkrete për përgatitjen e temave të diplomave. Departamenti ka drejtuar procesin e konsultimit për zgjedhjen e temave dhe pedagogëve udhëeqës për çdo student, duke e miratuar atë përfundimisht në fillim të semestrit të dytë të vitit të dytë të studimeve. [91.FE_Lista e Studentëve_tema e diplomes_udheheqes_.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive të marra gjatë dy viteve të studimit, ku një rol të rëndësishëm luan edhe udhëheqësi i studentit. U morën prononcime nga stafi dhe studentët e programit, <i>por nuk konstatojmë një evidencë, ku të përcaktohet krijimi dhe përbërja e komisionit të diplomimit.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, stafi akademik i asiston studentët në zgjedhjen e temave të diplomave, në përfundim të semestrit të parë të vitit të dytë të studimeve, duke ju

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

39

	<p>prezantuar interesat e tyre kërkimore-shkencore dhe mundësitë konkrete për bashkëpunime me subjekte ku mund të kryhet kërkimi.</p> <p><i>[64.FE_Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Msc ne MBA.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, pedagogët i informojnë studentët mbi mundësitë e ndihmës në procesin e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, brenda dhe jashtë selisë së UMT, por <i>mungon një evidencë specifike, për cilat tema diplome është kryer praktikisht diçka e tillë.</i></p> <p><i>[64.FE_Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Msc ne MBA.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, udhëheqësi luan një rol ndihmues ndaj studentit për analizën e të dhënave, nxjerrjen e rezultateve dhe përpunimin e tyre, si dhe vendos nëse duhet të japë miratimin për mbrojtjen e punimit. Përcaktimi i pedagogut udhëheqës të temës së diplomës, dhe detyrimet e tij bazohen në nenin 55 të Rregullores së UMT dhe nenet 3-4 të Rregullores së temës së diplomës, ndërsa <i>mungon një evidencë specifike, që qartëson zbatimin e detyrave të udhëheqësve në këtë proces.</i> Gjithsesi, prononcimet e studentëve në lidhje me funksionimin e këtij procesi ishin pozitive.</p> <p><i>[2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf, 64.FE_Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Msc ne MBA.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë, modalitetet për këtë përcaktohen në nenin 57 të Rregullores së UMT, por mungon një evidencë konfirmuese për vlerësimet konkrete (pikët e secilit anëtar komisioni dhe mesatarja e tyre) nga komisionet e diplomimit.</p> <p><i>[2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi, se në përfundimin të këtij program studimi, studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, të miratua nga MAS, sipas përcaktimeve të nenit 59 të Rregullores së UMT.</p> <p><i>[2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi, se në përfundimin të këtij programi studimi, studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit që ka ndjekur, nëse e kërkon një gjë të tillë. <i>Nuk saktësohet nëse ky veprim kryhet me pagesë nga ana e studentit.</i> Të dhënat e studentëve</p>



	arkivohen pa afat, të printuara (hardcopy) dhe në mënyrë dixhitale, në platformën edu4school. [95.FE_Rregullore e Sekretarisë.pdf, 111.FE_Rregullore e arkivës.pdf]			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ arriti në përfundimin që në këtë program studimi, UMT mban në ruajtje, pa afat, kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione, sa herë që kërkohen. [87.FE_Shembull_Dosje studenti të regjistruar.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër në programin e studimit Master i shkencave në Ekonomik- MBA  GVJ konstaton një tërësi dokumentash që argumentojnë përmbushjen e kriterit, si lista e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale, dosje personeli efektiv dhe me kontratë etj, të cilat disponohen nga departamenti përgjegjës, Departamenti i Shkencave të Administrimit si dhe zyra e burimeve njerëzore në institucion  [Evidenca 66.FE_Lista e plotë e personelit akademik me kohe të plotë, me kohë të pjesshme_FE_Tab.Nr.2.pdf, 68.FE_Të dhëna statistikore të personelit akademik PAE_PAK_Tab.Nr. 1.pdf; 69.FE_Të dhëna për

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

41

	<i>mbulimin e lëndëve me personel akademik_Msc ne MBA_Tab.Nr.3.pdf; 71.FE_Model i formularit të vlerësimit të performancës.pdf]</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	GVJ mbështetur në dokumentacionin në dosjen e vetëvlerësimit, si dhe gjatë vizitës në institucion, konstaton se procedurat e rekrutimit të stafit akademik mbështeten në legjislacionin në fuqi, si dhe në statutin dhe rregulloren e institucionit <i>[Procedure rekrutime fe.pdf, vizita në institucion]</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Referuar procedurës së rekrutimit të konsultuar gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, harton kërkesa të përgjithshme, si dhe kriteret preferenciale për stafin e programit.  Nga vizita në institucion rezulton se kërkesat burojnë nga nevojat e njësisë përgjegjëse për staf akademik, ato përcillen në njësinë kryesore e në vijim në rektoratin e institucionit, sëbashku me kriteret specifike, për lëndët, botimet etj.  Referuar politikës së rekrutimeve, Universiteti Metropolitan “Tirana”, rezulton se institucioni publikon në faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe atyre me kohë të pjeshme, në të cilën deklarohet pozicioni vakant kriteret dhe procedura e përzgjedhjes.  <i>[29.UMT_Udhezim mbi politikat e procedura e punësimit të personelit akademik në UMT.pdf; Procedure rekrutime fe.pdf, pika 8 e Vendimit të senatit Akademik - vizita në institucion]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Referuar procedurës së konsultuar të rekrutimit, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, harton dhe zbaton procedura rekrutimi, të mbështetura në vlerësimin e aplikantëve në dy faza, atë të vlerësim dosjes dhe atë të intervistës. Vlerësimi i dosjes rezulton se bëhet nëpërmjet vlerësimit të kriterëve të përgjithëshme dhe specifike, nga komisioni i përbërë nga 5 anëtarë, me përfaqësues të departamentit, dekanatit dhe rektoratit.  <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf; Procedure rekrutimi, vizita në institucion]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për	Referuar RVB, dosjes së vlerësimit si dhe vizitës së ambienteve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

42

<p>krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universitetit Metropolitan “Tirana”, GVJ konstaton se institucioni vendos në dispozicion të stafëve mjedise të përshtatshme, me kapacitet të pranueshëm, në përputhje me numrin e stafit për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve në mënyrë profesionale. [107.1-2-3 FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf; 107.FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të institucionit dhe stafin akademik, rezultoi se Universiteti Metropolitan “Tirana”, në saj të bashkëpunimeve që ka me Universitete dhe rrjete ndërkombëtare organizatash, mbështet, nxit dhe mundëson pjesëmarrjen e stafëve në aktivitete, trajnime, konferenca të organizuara nga këto rrjete dhe që i shërbejnë ngritjes shkencore të stafit akademik.  [Evidenca shtese MET.pdf, Evidenca 3.4.8; Shkresë Dërgohen evidencat shtese në kuadër të riakreditimit të programit të studimit MSC në "Ekonomik- MBA" pranë Universitetit "Metropolitan Tirana", 22.UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimit në rrjete.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GE konstatoi nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit por edhe nga vizita në institucion, se Universiteti Metropolitan “Tirana”, mbështet plotësimin e nevojave të stafit, vlerëson nevojat për trajnim të stafëve për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Në këtë kontekst institucioni rezultoi se ka realizuar trajnime për metodat inovative të mësimdhënies, leksione të hapura me lektorë të huaj, ka nxitur pjesëmarrjen e stafit në trajnime të zhvilluara nga AKKSHI për aplikimin në projekte të kërkimit shkencor etj. [Evidenca 116.FE_Ëebsite Dosje e leksioneve me profesor të huaj.pdf; 118.Proçesi i trajnimit të pedagogëve mbi metodat e mësimdhënies + Projekti Bolonja.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>GVJ mbështetur në takimet me stafin akademik të programit Msc Ekonomik-MBA, si dhe me GVB, vlerëson pozitivisht angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

43

<b>praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e Universitetit Metropolitan “Tirana”, konstaton se Institucioni ka në dispozicion dy godina me sipërfaqe respektive, 2347 m<sup>2</sup> dhe 2490 m<sup>2</sup>. Mjediset janë mjediset të përshatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve. Duke qenë se studentët e masterit e zhvillojnë mësimin në pasdite, rezulton se mjediset kanë një përdorim optimal dhe në përputhje me nevojat e studentëve të programit të studimit Msc. Në Ekonomik-MBA.</p> <p><i>[Evidenca 108.FE_Asete infrastrukturore akademike _UMT.pdf; 107.FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga RVB dhe nga vizita në institucion, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët janë të pajisura me pajisje audiovizive, PC, videoprojektor, internet ëirless etj, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Referuar vizitës në institucion, gjenden 6 laboratorë informatikë, një prej të cilëve është në dispozicion të studentëve të PS Msc në Ekonomik-MBA.</p> <p><i>[Evidenca 108.FE_Asete infrastrukturore akademike _UMT.pdf; 107.FE_Ambjentet për Infrastrukturën te UMT-FE.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas informacionit të siguruar nga dosja e vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion, rezulton se laboratorët informatikë janë të pajisur me pajisjet hardëerike të duhura si dhe me softet specifike, në ndihmë të objektivave të programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sic rezulton nga të dhënat infrastrukturale dhe nga vizita në institucion, institucioni vë në dispozicion të studentëve 6 laboratorë informatikë, një prej të cilëve rezulton në dispozicion të studentëve të PS Msc. në Ekonomik MBA</p> <p><i>[Evidenca 108.FE_Asete infrastrukturore akademike _UMT.pdf; 86.FE_Donacionet nga projektet për laboratorët.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Referuar vizitës në institucion si dhe RVB rezulton se studentët i zhvillojnë praktikën pranë institucioneve/kompanive të ndryshme. Nga dosja e vetëvlerësimit, konstatohet se Universiteti Metropolitan “Tirana”, disponon një tërësi marrëveshjes me institucione të ndryshme, të cilat mbështesin dhe mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale, të studentëve të MSC Ekonomik-MBA kryesisht në mjediset e tyre, si me sistemin bankar, Raiffaisen Bank, Credins Bank, Union Bank, te cilat u konsultuan në dokumentacionin e siguruar nga vizita në institucion <i>[Evidenca shtese MET.pdf, vizita ne institucion]</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)

	[Evidenca 75.FE_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në proces të FE.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se UMT, vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore e cila është ka një fond librash, në gjuhë shqipe dhe të huaj, periodikë, revista shkencore etj [Evidencë;109.FE_Relacion bibliotekën (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike_UMT-FE.pdf]
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka rezulton të këtë 758 tituj, libra në gjuhë shqipe dhe të huaj, revista shkencore, literaturë bazë dhe ndihmëse sipas syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Msc. në Ekonomik-MBA. [Evidencë;109.FE_Relacion bibliotekën (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike_UMT-FE.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga RVB dhe nga takimet me studentët e programit, rezultojnë se ata kanë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës, të fondit të saj fizik por ata kanë akses edhe në disa biblioteka elektronike, të shfrytëzueshme jo vetëm në mjediset e institucionit por edhe jashtë tij, nëpërmjet kredencialeve të studentëve. <a href="http://ëëë.doaj.org">ëëë.doaj.org</a> <a href="http://ëëë.cobis.org">ëëë.cobis.org</a> <a href="http://ëëë.gutenberg.org">ëëë.gutenberg.org</a> etj.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka rezulton e pajisur me kompjutera me softë respektive për manaxhimin e bazës së të dhënave të bibliotekës si dhe me pajisje të tjera si fotokopje e pajisje skanuese. Hapësira fizike dhe kapacitet pritëse të bibliotekës konsiderohen të limituara nga GVJ. Edhe pse një mjedis që fton studentët dhe një klimë e mirë aktuale, GVJ do të sugjeronte shtimin e kapaciteteve fizike, posteve dhe pc në bibliotekën e UMT.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të	Nga takimi me drejtues të institucionit si dhe me GVB, rezulton se institucioni synon pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës, nëpërmjet marrëveshjeve për përdorimin e fondeve të bibliotekave të instucioneve

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

45

programit.	<p>partnere apo shfrytëzimin e U-library në të ardhmen për të cilën është drejt finalizimit marrëveshja.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ është e mendimit që UMT, të gjejë mekanizma të tjerë edhe për rritjen e financimit të mëtejshëm për një fond më të pasur fizik si dhe për mjedise shfrytëzimi të bibliotekës me kapacitete me të mëdha, duke i praraprirë numrit të studentëve në rritje si dhe numrit me të lartë të programeve.</i></p> <p><i>[RVB; Vizita në institucion]</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	<p>GVJ konstaton se biblioteka funksionon në orare në përshtatje me nevojën për shfrytëzim nga ana e studentëve të Msc. në Ekonomi-MBA. Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekat elektronike, në të cilat UMT rezultojnë i regjistruar, duke rritur fleksibilitetin e përdorimit të bibliotekës si <a href="http://www.doaj.org">www.doaj.org</a>, <a href="http://www.cobis.org">www.cobis.org</a>, <a href="http://www.gutenberg.org">www.gutenberg.org</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar rregullores së UMT, konstaton se të dhënat në UMT për programin e studimit Msc. Ekonomik-MBA, mbahen në dy forma, regjistrat manualë dhe regjistrat elektronik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. Përveç formave manuale, GVJ konstatoi një sistem informacioni funksional, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në PS Msc. Ekonomik-MBA, i cili është pjesë e një sistemi të integruar informacioni në nivel institucional në UMT.</p> <p>Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezultojnë se zyra e burimeve njerëzore administrojnë të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrative.</p> <p>Referuar takimit me studentët e Msc ekonomik -MBA, rezultojnë se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive, nëpërmjet sistemit të informacionit të integruar. GVJ nga RVB si dhe nga vizita në institucion, konstaton se sistemi i informacionit përqendrohet në dy platforma, “edu4school” dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

46

	<p>“Gotomeeting”.</p> <p>[49.UMT_Udhezim mbi mesidhenien ne distance.pdf; 43.UMT_Sistemi informatik i menaxhimit te studenteve.pdf; 48.UMT_Platformat per mesimin online.pdf]</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se sistemi i Manaxhimit të informacionit, “edu4schools” rezulton një platformë e cila ka të integruar 4 module, të cilat sigurojnë informacion dhe ju japin akses sekretarisë mësimore, studentëve, zyrës së menaxhimit financiar si dhe stafit akademik, duke ofruar shërbimin e informimit të tyre të ndërsjellë dhe të komunikimit të integruar.</p> <p>Nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezultojnë se përveç platformës “edu4schools”, në shërbim të tyre për zhvillimin e mësimin është edhe platforma “Gotomeeting”, që shërben për mësimdhënien online</p> <p>[103.FE_Ndërfaqe classroom e një pedagogu.pdf; 49.UMT_Udhezim mbi mesidhenien ne distance.pdf]</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sipas informacionit të siguruar gjatë takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezultojnë se prej dy platformave gjenerohen raportime për drejtuesit, dhe mund të realizohen monitorime për procese të ndryshme, për zhvillimin e mësimin, për informimin e studentëve, duke i shërbyer vendimmarrësve për marrjen e vendimeve.</p> <p>[43.UMT_Sistemi informatik i menaxhimit te studenteve.pdf; 48.UMT_Platformat per mesimin online.pdf]</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>GVJ nga vizita e faqes zyrtare të institucionit, rezultojnë se aty publikohen informacione për stafin akademik, programet mësimore, kuotat, kriteret, aktivitetet, projektet etj në dy gjuhë, shqip dhe anglisht</p> <p>[<a href="https://umt.edu.al/en/about-mtu">https://umt.edu.al/en/about-mtu</a>; <a href="https://umt.edu.al/en/research-and-projects">https://umt.edu.al/en/research-and-projects</a>; <a href="https://umt.edu.al/programet-master">https://umt.edu.al/programet-master</a>]</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi IV.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme</p>	<p>GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, UMT harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezultojnë të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon nëpër të gjitha nivelet hierarkike, për njohje dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

47

<p>për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>sugjerime, për miratim final në bordin e Administrimit. Të ardhurat dhe shpenzimet, janë të detajuara sipas burimeve dhe sipas zërave të shpenzimeve.</p> <p>Referuar evidencës së konsultuar nga GVJ, rezulton se gjenden të detajuara të ardhurat nga tarifat apo të ardhurat nga projektet, financimi nga administrator i UMT, si dhe shpenzimet sipas zërave të ndryshëm.</p> <p>Sipas RVB, institucioni deklaron se në fazën e aplikimit të hapjes së programit Msc Ekonomik-MBA, është paraqitur një raport i detajuar, mbi financimin, kostot për student si dhe planifikimi për ecurinë e programit.</p> <p><i>[Evidenca 96.FE_Buxheti i UMT_FE.pdf; 115.FE_Shpenzimet dhe te ardhurt FE në 3 vitet e fundit_Tab.Nr.10.pdf; 97.FE_Raporti Auditues Pasqyrat Financiare Viti 2020.pdf; 73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar_FE.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Pavarësisht se GVJ nuk konstatoi plan financimi në nivel programor, referuar vizitës në UMT dhe nga RVB, konstaton se buxheti pavarësisht se paraqitet në nivel institucion në formën e tij finale, mënyra e hartimit të tij, përfshin disa nivele, nga poshtë -lart, duke nisur propozimet nga departamenti, të cilat paraqesin kërkesat buxhetore për financim, nisur nga nga kërkesat për të mbështetur cdo program studimi, për burime njerëzore, për shpenzime operative, për teknologjitë, shpenzimet për bibliotekën etj.</p> <p>Në vijim buxheti planfikohet në nivel njësie kryesore, zyra e financës sintetizon buxhetin për të gjithë zërat në nivel institucioni dhe ia paraqet Senatit, i cili bën miratimin paraprak, për të vijuar memiratin nga Bordi i Administrimit të UMT</p> <p><i>[Evidenca 96.FE_Buxheti i UMT_FE.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me GVB, rezulton se institucioni kryen auditime të pavaruara nga kompani auditi të certifikuar, të përvitshme, por gjithashtu nga strukturat e UMT, ku zbatimi i buxhetit dhe pozicioni financiar i UMT është detyrë funksionale e zyrës së financës në UMT, në përputhje me rregulloren e institucionit.</p> <p>GVJ për këtë kriter i referohet RVB, si dhe të dhënave për të ardhurat dhe shpenzimet që institucioni ka depozituar në dosjen e vlerësimit të brendshëm si dhe raportit të auditimit që gjenden në dosjen e vetëvlerësimit</p> <p><i>[Evidenca 96.FE_Buxheti i UMT_FE.pdf; 115.FE_Shpenzimet dhe te ardhurt FE në 3 vitet e fundit_Tab.Nr.10.pdf; 97.FE_Raporti Auditues Pasqyrat Financiare Viti 2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe</p>	<p>Referuar RVB si dhe raporteve vjetore në DVV, rezultojnë se është përcjellë informacion për të ardhurat dhe shpenzimet, në mënyrë analitike sipas zërave.</p> <p>Këto të dhëna, janë në nivel institucional dhe paraqiten në mënyrë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

48



diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	sintetike. [Evidenca 73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar_FE.pdf]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Rezultoni se UMT, ka një strukturë të posaçme për manaxhimin financiar sic dëshmohet nëpërmjet RVB. Këto struktura auditohen nga auditime të pavarura të certifikuara, të cilat dëshmojnë për qëndrueshmërinë financiare të institucionit, në mënyrë të përvitshme. [Evidenca 73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar_FE.pdf; [Evidenca 96.FE_Buxheti i UMT_FE.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ referuar dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit si dhe nga informacioni i siguruar në institucion, konstaton se UMT disponon politika dhe procedura të cilat në vijim i zbaton për studentët e programit të studimit Msc. Ekonomik-MBA. GVJ është e mendimit se këto politika dhe procedura janë në përputhje me bazën ligjore rregullative.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se UMT ka një sërë rregulloresh dhe procedurash, duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë nga hyrja deri në diplomim, të studentëve në PS Msc. Ekonomik-MBA  Orientimi dhe këshillimi i studentëve është i sanksionuar në dokumentat strategjik të institucionit  Ky informim nis nga momenti i informimit për programet akademike, para fillimit të cdo viti, nëpërmjet ëeb sitit të UMT ku gjenden të publikuara, programet, planet mësimore si dhe kuotat e kriteret GVJ referuar evidencave si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e PS Msc. Ekonomik-MBA, është e mendimit se aktet rregullatore ku

Adresa: "Ruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

49

	<p>sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Referuar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuentimit, të ankimimit si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve, orientohen drejt garantimit të barazisë, paanshmërisë dhe transparencës dhe zbatimit të udhëzimeve dhe akteve nënligjore</p> <p><i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; 30.UMT_Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf; 34.UMT_Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT (2021-2022).pdf; 2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; 87.FE_Shembull_Dosje studenti të regjistruar.pdf; 36.UMT_Publikimi në ëeb të UMT_së të gjithë njoftimeve (linku përkatë; 77.FE_Rregullore e Zyres se Këshillimit të Karrieres FE,.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ është e mendimit se procedurat që UMT disponon për pranimet, transferimet për vlerësimin e dijeve apo për diplomimin, janë procedura të cilat janë transparente, të aksesueshme dhe të kuptueshme nga palët e interesuara.</p> <p><i>30.UMT_Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf; 99.FE_Propozimi i fakultetit për kuotat e pranimit.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB si dhe dosjes së vetëvlerësimit, ëebit të fakultetit dhe takimeve me drejtues të institucionit, rezulton se kuotat për Msc. Ekonomik në MBA, propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga senati. Kuotat dhe kriteret gjenden te publikuara në faqen zyrtare të UMT. Referuar kriterëve, rezulton se nuk ka kriteret të veçanta, përveç atyre që parashikohen në aktet ligjore të MAS.</p> <p><i>[99.FE_Propozimi i fakultetit për kuotat e pranimit.pdf; https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-master]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Përveç publikimet në faqen zyrtare të UMT, ku konstatohet informacion I plotë për kuotat, kriteret dhe procedurën e aplikimit edhe strukturat e institucionit, njësia kryesore dhe njësia bazë si dhe zyra e pranimit në UMT, rezulton se informojnë dhe udhëzojnë studentët e interesuar.Këto orientime përcillen edhe nëpërmjet guidës së studentit, nëpërmjet panairove të studimit etj.</p> <p><i>[36.UMT_Publikimi në ëeb të UMT_së të gjithë njoftimeve (linku përkatëse).pdf; 79.FE_Guida e studentit.pdf; 80.FE_Shembull_Java e orientimit_FE.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton nga takimet me studentët e programit si dhe nga dosja e vetevlerësimit se strukturat e UMT, ofrojnë informacion të plotë rreth kriterëve për të kaluar nga një vit në tjetrin. Studentët rezultojnë se informohen për detyrimet lëndore apo kriteret e frekuentimit nga stafi akademik i programit, në fillim të cdo semestri. Këto detyrime janë të sanksionuara në rregulloren e institucionit dhe të njësisë kryesore. [Evidenca 50.FE_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf ; 58.FE_Rregullore e programit.pdf]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Në informacionet e publikuara për studentët rezultojnë edhe procedurat e transferimeve të studimeve si dhe të kërkesave që duhet të plotësohen, sic janë detyrimet e njohjes së gjuhës së huaj, për të cilat studentët rezultojnë të informuar [79.FE_Guida e studentit.pdf; 30.UMT_Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf]			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi me studentët e programit, stafin akademik si dhe përfaqësues së zyrës së këshillimit të studentëve, rezulton se studentët informohen cdo fillim semestri prej pedagogëve të lëndëve për procedurat e vlerësimit të dijeve. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe javët orientuese që institucioni mban, për të orientuar studentët që aspirojnë të regjistrohen në këto programe, apo që tashmë janë regjistruar [80.FE_Shembull_Java e orientimit_FE.pdf]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në kuadër të informimit të plotë të studentëve dhe orientimit të tyre, rezulton se njësia bazë informon studentët për kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes së punimit të mikrotezës. Studentëve iu vihet në dispozicion udhëzuesi i diplomës, ndjekjen e zbatimit të së cilit e realizojnë udhëheqsit e diplomës [64.FE_Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Msc në MBA.pdf; 65.FE_Plan pune për punimin e diplomës_Msc në MBA.pdf]			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga takimi me përfaqësues së zyrës e karrierës, UMT orienton studentët potencial, nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë me ta si dhe organizimit të javës orientuese. Gjithashtu një instrument tjetër informimi orientimi në kohë reale, institucioni përdor edhe rrjetet sociale si dhe ëeb sitin e institucionit. [80.FE_Shembull_Java e orientimit_FE.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

51

<b>Standardi V.3</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Gvj nga vizita në institucion si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se UMT nëpërmjet organizimit të javëve orientuese, takimeve të drejtuesve me studentët, i orienton ata për kohëzgjatjen e studimeve, për strukturën e programit, për organizimin dhe zhvillimin e tij, etj [80.FE_Shembull_Java e orientimit_FE.pdf]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Takimet me studentët dëshmuar se ata janë të informuar rreth lëndëve, moduleve, formave të vlerësimit, detyrimeve lëndore. Këto informacione jepen kryesisht nga pedagogët në seancën e parë të zhvillimit të semestrit. Studentët nëpërmjet sistemit “edu4schools”, marrin informacion në kohë reale për modulet, lëndët dhe cdo informacion rreth dosjes së programit Msc Ekonomik-MBA			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga dosja e vetëvlerësimit si dhe nga takimet në institucion, rezultojnë strukturat e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, por edhe zyra e karrierës, informojnë studentët e Msc Ekonomik-MBA, rreth mundësive të intershipit apo të punësimit dhe orientimit për zhvillimin e karrierës. [80.FE_Shembull_Java e orientimit_FE.pdf]			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Javët e informimit, rezultojnë se janë orientuese për t'i aklimatizuar studentët me mjedisin e UMT. Nëpërmjet sekretarisë, departamentit, si dhe nëpërmjet ëeb sitit e guidës së studentit, studentët informohen për organizimin e procesit mësimor, orarit, sallave/laboratorëve etj. [77.FE_Rregullore e Zyres se Këshillimit të Karrieres FE,.pdf; 80.FE_Shembull_Java e orientimit_FE.pdf]			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përvec aktiviteve informuese sic janë javët orientuese si dhe informacionit verbal, studentët rezultojnë se përdorin aktivisht platformën edu4schools, për të marrë informacion rreth syllabuseve, leksioneve, detyrimeve lëndore, rezultatet e provimeve etj. [43.UMT_Sistemi_informatik_i_menaxhimit_te_studenteve.pdf; 44.UMT_Manuale_përdorimi_të_Sistemit_informatik_te_studenteve.pdf]			
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Referuar DVV si dhe vizitës në institucion, rezultojnë se edu4schools, është një sistem i brendshëm informacioni, që integron dhe administron informacionin e sekretarisë, të stafit akademik si dhe të zyrës së financës. [43.UMT_Sistemi_informatik_i_menaxhimit_te_studenteve.pdf; 45.UMT_Ndërfaqja (Administratori, Pedagogu, Sekretaria, Studenti).pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

52

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në UMT si dhe takimeve me përfaqësues të sekretarisë mësimore, konstaton se UMT, disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për PS Msc Ekonomik-MBA. Sipas informacionit të siguruar përveç regjistrave të institucionit, që GVJ konsultoi, këto informacione ruhen edhe në mënyrë elektronike në platformën “edu4scholls”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi regjistrat themeltar për Msc Ekonomik-MBA, të cilët kanë të regjistruarit e cdo viti, studentët e larguar apo të tërhequr si dhe të diplomuarit e cdo viti.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2017-2018 42 studentë</li> <li>- 2018-2019 19 studentë</li> <li>- 2019-2020 18 studentë</li> <li>- 2020-2021 17 studentë</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ konsultoi proceverbale të lëndëve, vlerësimet e studentëve për lëndë të ndryshme, si dhe regjistrat e notave dhe konstatoi përputhshmëri mes formave të vlerësimit në syllabus si dhe regjistrave të notave. Nga takimi me studentët rezultoi se studentët për vlerësimet e tyre informohen nëpërmjet sistemit informatik, “edu4scholls”, në të cilin pedagogët hedhin vlerësimet e lëndës, ku cdo përdorues aksesohet nëpërmjet kredencialeve individuale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>UMT disponon të dhëna për ecurinë e studentëve, gjatë zhvillimit të programit të studimit, Msc Ekonomik-MBA, që nga pranimi (mesataren në hyrje), deri në diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore, për identifikuar ndryshimet në cilësinë e aplikimeve dhe pranimeve.</p> <p>Rezultoni se mesatarja në hyrje rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2018-2019 6.8</li> </ul>

<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	- 2019-2020 6.3 - 2020-2021 7.28  Rezulton se mesatarja në dalje rezulton:  - 2017-2018 7.98 - 2018-2019 9.2 - 2019-2020 7.51  GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi regjistrat themeltar ku çdo student, është regjistruar dhe ishte pajisur me numër matrikullimi.  Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e bachelorit, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, dëshmi e gjuhës së huaj etj <i>[Evidenca Tabelat Permbledhese.pdf; 119.Procesverbal provimi I mbrojtjes se diplomes.pdf; 95.FE_Rregullore e Sekretarisë.pdf; 87.FE_Shembull_Dosje studenti të regjistruar.pdf]</i>			
	<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht

<b>Standardi V.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullore të vetë IAL-ve.	Referuar vizitës në institucion si dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore, asaj bazë si dhe me studentë të programit Msc Ekonomik-MBA, UMT në aktet e brendshme rregullore, Statut, Rregullore dhe Rregullore e Senatit Studentor, parashikon përfshirjen e studentëve në organe vendimmarrëse, si senat, NJSBC, komisione ad-hoc etj <i>[1.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf; 2.UMT_Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; 12.UMT_Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf; 105.FE_Rregullore e Senatit Studentor UMT.pdf]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga informacioni i siguruar nga DVV dhe nga takimet me drejtues, staf dhe studentët e programit Msc. Ekonomik-MBA, GVJ është e mendimit se UMT, nxit dhe garanton përfshirjen e studentëve, në organe vendimmarrëse si senati akademik, përfshirje në NJSBC dhe në komisione ad-hoc. Gjithashtu nëpërmjet pyetësorëve, studentët përcjellin në organet vendimmarrëse perceptimin e tyre, rreth proceseve mësimore dhe atyre vlerësuese. <i>[12.UMT_Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf; 106.FE_Shembull_Kërkesa të ndryshme të Këshillit Studentor të</i>

	<i>FE.pdf; 104.FE_Aktivite të kryera nga studentët_ qeveri studentore UMT-FE.pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	GVJ është e mendimit se UMT në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, Msc. Ekonomik-MBA, mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe se disponon procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Sic rezultoi nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të studentëve dhe të NJSBC, institucioni organizon dy herë në vit, pyetësorë për studentët për të siguruar informacion dhe sugjerime prej tyre rreth, ecurisë së programit të studimit. <i>[Evidenca 85.FE_Format pyetësori studenti.pdf]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre  Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët e PS Msc Ekonomik -MBA, rezulton se ata kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit dhe konsultimit me tezën e provimit për tu qartësuar për vlerësimin e tyre.  Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre, mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.  <i>[Evidenca 101.UMT_Rregullore e Provimeve.pdf; 85.FE_Format pyetësori studenti.pdf]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Referuar takimeve me stafin akademik të programit dhe dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se stafi akademik i njësisë bazë përgjegjëse për Msc Ekonomik-MBA, merr pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si ne Hungari, Bullgari, Spanje, Suedi etj. Stafi akademik është aplikues dhe fitues në projekte të karakterit aplikativ, te tilla si është projekti MIC. Ne kuadër te tij nga vizita ne institucion rezultojnë se janë kryer nje tërësi aktivitesh nga stafi i departamentit dhe i

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

55

	<p>programit te studimit MBA, si ëëbinare, leksione te hapura per sipërmarrjet sociale, ku rezultojnë 6 pedagoge te perfshire <i>[shih Evidenca shitese MET.pdf, pika 8, vizita ne institucion]</i></p> <p><i>[73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar_FE.pdf; 100.FE_Lista e Konferencave shkencore.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se UMT disponon një tërësi marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të huaja dhe vendase në kuadër të bashkëpunimit, për studime, konferenca të përbashkëta dhe projekte të përbashkëta. Nder këto universitete rezultojnë universitete perendimore si Universiti i Marche, Itali, Universiteti i Mesines, Itali, Universiteti Suceava Rumani etj.</p> <p><i>[22.UMT_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf; 24.UMT_Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Nga takimet me stafin dhe studentët e programit, rezulton se institucioni nxit studentët të përfshihen në projekte dhe në publikime në bashkëpunim me stafin akademik të programit. Studentë nxiten të bëhen pjesë e konkurseve që zhvillohen, ku prezantojnë projektet e tyre. Për studentët ekselentë parashikohen edhe politika motivuese.</p> <p><i>[83.Rregullore per studentet e shkelqyer.pdf]</i></p> <p>Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, janë kusht jo vetëm për promovimin akademik të stafit, por rezulton se institucioni nxit dhe promovon përfshirjen e stafeve në konferenca shkencore si dhe të botimeve shkencore cilësore. Nga vizita në institucion rezulton se institucioni ka edhe revisitë shkencore organ i UMT, në të cilën politika e botimit rezulton favorizuese për stafet, duke qenë se parashikon tarifa botimi lehtësisht të përballeshme.</p> <p><i>[93.FE_Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik të FE.pdf; 94.FE_Aplikimet për kërkim shkencor, email për thirrjet.pdf; 100.FE_Lista e Konferencave shkencore.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër</p>	<p>Udhëheqja dhe asistenca e stafit akademik për përgatitjen dhe realizimin e diplomës janë të sanksionuara në rregullore. Nga takimet me stafin dhe studentët, konstatohet se stafi mbështet, orienton dhe udhëheq studentët</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

56



të realizimit të diplomës	drejt përmbushjes së detyrimeve që kërkon realizimi i temës së diplomës. [64.FE_Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës Msc ne MBA.pdf; 65.FE_Plan pune për punimin e diplomës Msc ne MBA.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ konstaton se UMT, ka nënshkruar një tërësi marrëveshjesh bashkëpunimi që synojnë të nxisin përfshirjen e stafit akademik në kërkime shkencore të përbashkëta, si dhe në mobilitete për stafin akademik. GVJ gjate vizitës ne institucion dhe takimeve me përfaqësues te zyrës se projekteve, konstatoi se janë 10 pedagoge te MBA Ekonomik, qe kane aplikuar dhe përfituar nga programet e shkëmbimit te stafit akademik, ne kuadër te programit Erasmus+, ne rruge institucionale. [23.UMT_Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FE.pdf ; 94.FE_Aplikimet për kërkim shkencor, email për thirrjet.pdf ; 93.FE_Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik të FE.pdf, ndihmësakademik për trajnim dhe të studentëve të programit.]
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Referuar informacionit të siguruar gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se stafi akademik i programit përdor metoda inovative dhe nxit studentët drejt hulumtimeve dhe kërkimeve sekondare e primare, duke i shërbyer parapërgatitjes së tyre për të studimet e ciklit të tretë. [56.FE_Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	GVJ konstaton se UMT nxit përfshirjen e studentëve të masterit shkencor por edhe të studiuesve te rinj, pjesë e stafit stafit akademik në projekte kërkimore, që dëshmojnë nga informacioni në dosjen e e vetëvlerësimit, për projektet ku UMT ka aplikuar. [24.UMT_Lista e projekteve te aplikuar nga UMT dhe projektet fituese.pdf]
<b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Nga vizita ne institucion dhe nga DVV, GVJ konstaton se UMT në kuadër të marrëveshjeve që ka dhe bashkëpunimeve me universitete të huaja, ka ftuar lektorë kërkues të huaj nga universitetet europiane dhe nga USA, gjithashtu kjo demonstron edhe me mbulimin e disa lëndëve në planin mësimor të Ps, Msc Ekonomik-MBA, të lektorëve të huaj, që mbulojnë lëndë të tilla si Strategji Biznesi e Avancuar si dhe Strategji Marketingu. [57.FE_Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies_Tabela nr. 4.pdf; 75.FE_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në proces të FE.pdf;

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

57

	<i>72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf; 27.UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimitmobilitetit.pdf</i>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Institucioni rezulton se nxit përfshirjen e studentëve për të përfutur mobilitete në universitete të huaja.</p> <p>Studentët mbështeten, orientohen nga zyrat mbështetëse që të aplikojnë për të përfutur nga mobilitetet e projekteve Erasmus. GVJ vlerëson punën e këtyre strukturave. Rezulton se janë 6 studente te MBA-Ekonomik qe kane përfutur, nder te cilët dy studente ishin duke kryer mobilitetin ne Ceki dhe Letoni, ne kohen kur GVJ kreu viziten ne institucion.</p> <p>Në UMT rezulton se institucioni fton lektorë të huaj që kanë mbajtur leksione të hapura për studentët dhe stafin e ri, si dhe lektorë të huaj të cilët në programin Msc. Ekonomik-MBA, mbulojne lëndë të caktuara sic eshte lënda e Stragjise se Biznesit</p> <p><i>[72.FE_Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve_FE.pdf; 27.UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimitmobilitetit.pdf]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga struktura organizative e UMT, GVJ konstaton se UMT ka procedura dhe njësi të posaçme në strukturën organizative që kanë në fokus shërbimin e informimit të studentëve, që në fazën e hyrjes deri në diplomim. Këto shërbime ofrohen kryesisht nga zyra e karrierës si dhe nga Drejtoria e komunikimit në rektorat. Format e informimit janë të ndryshme, nëpërmjet rregulloreve, guidës, fletëpalosjeve, komunikimit verbal, komunikimit elektronik nëpërmjet sistemit edu4schools etj.</p> <p><i>[51.FE_StrukturaOrganigrama e FE.pdf; 79.FE_Guida e studentit.pdf]</i></p> <p>GVJ konstaton se UMT ka funksional sistemin për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre, për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe PS Msc. Ekonomik-MBA</p> <p>Ky sistem mbështetet edhe nga informimi në rrjetet sociale të studentëve, si kanale të komunikimit efektiv me studentët</p> <p>Faqja zyrtare e UMT, është një tjetër mundësi nëpërmjet të cilës studentët mund të sigurojnë informacion për programet, lëndët, kriteret, kuotat, oraret, mobilitetet, transferimet etj</p> <p>Nga takimi me përfaqësues të sekretarisë dhe zyrës së karrierës dhe të</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

58

në tregun e punës.	studentëve, rezulton se kjo zyrë, asiston studentët dhe këshillon ata për ecurinë e karierrës së tyre, duke i orientuar drejt mundësive të punësimit, apo për oportunitetet e zgjedhjes dhe zhvillimit të praktikës profesionale, pranë kompanive, më të cilat UMT ka marrëveshje dhe që konsiderohen aktive, si dhe për trajnimet e ndryshme për studentët [120.Raport javor i zyrës së Sherbimit ndaj studentit.pdf]			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karierrës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Referuar DVV si dhe takimeve përfaqësues të zyrës, institucioni nëpërmjet zyrës së këshillimit të karierrës, kryesisht, ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, nëpërmjet pyetësorit të Alumnit, duke azhurnuar të dhënat me të diplomuarit si dhe më punësimin e tyre. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe disa takime online me ish studentët e UMT. Në vijim institucioni, përgatit statistika për punësimin e studentëve për organet drejtuese për vendimmarrje të ndryshme të tyre. [81.Lista e studenteve Alumni.pdf; 82.FE_Rrjeti Alumni UMT.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

### Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

59

**Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

**Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

**Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

**Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit

GVJ referuar DVV si dhe takimeve në institucion, konstaton se UMT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni.

Përgjegjësitë e NJSBC, janë sanksionuar në statutin dhe rregulloren e UMT. Kjo njësi përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, ka në përbërjen e vetë anëtarë nga njësitë kryesore të UMT si dhe ekspertë të jashtëm.

[7.UMT\_VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf; 8.UMT\_Përbërja e NJSBC.pdf; 1.UMT\_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana (miratuar me urdher ministri).pdf]

NJSBC në UMT, referuar takimeve në institucion, operon duke përdorur disa mekanizma dhe duke integruar rezultatet që këto mekanizma sigurojnë. NJSBC organizon takime studentët e programit, pyetësorë dhe sondazhe me studentët. GVJ vlerëson pozitivisht praktikën e ndjekur nga institucioni për përfshirjen jo vetëm të aktorëve të brendshëm, por edhe të ekspertëve të jashtëm për përmirësimin e cilësisë.

[10.UMT\_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf; 11.UMT\_Model i pyetësorit për studentet (Anketa).pdf; 12.UMT\_Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf]

Nga dosja e vetëvlerësimit konstaton se UMT është akredituar në vitin 2017 institucionalisht, në 2019 po ashtu duke qenë se është riorganizuar duke shtuar një njësi kryesore dhe duke u orientuar drejt përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë

Nga takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezultoi se përveç NJSBC mekanizmat e sigurimit të cilësisë përdoren edhe nga njësitë bazë përgjegjëse për programin Msc Ekonomik-MBA

Njësia bazë rezulton se:

Nëpërmjet komisioneve ad hoc zhvillon monitorime dhe vlerësime të procesve akademike të stafeve.

Përgjegjësi i departamentit, në përfundim të cdo viti akademik, bën vlerësimin e performancës, për aktivitetet mësimore, atë kerkimore shkencore si dhe kontributin institucional

Titullarët e lëndëve bëjnë vlerësimin e performancës për stafet me kontratë, të cilat shërbejnë si bazë për rilidhjen e kontratës

GVJ konstaton nga takimi me studentët, drejtuesit, stafin akademik si dhe përfaqësues të NJSBC, përdor mekanizma të ndryshëm që synojnë vlerësimin të cilësisë së programit të studimeve.

Përveç pyetësorëve, takimeve, kontrolleve nga departamentet realizohen nga njësia bazë edhe kontrolli i provimeve dhe syllabuseve me qëllim që të monitorohen proceset e ndryshme.

Rezultoni se institucioni përveç mekanizmave të vlerësimit të brendshëm, i

nënshtrohet vlerësimi të jashtëm periodik programor dhe rezulton se ndërmer plan masash, për zbatim të rekomandimeve duke i shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

*[10.UMT\_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf]*

Për sa më sipër GVJ konsultoi formate pyetësorësh, plane masash për zbatim rekomandimesh, në DVV si dhe nga infomacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion.

*[[19. UMT\_Pyetesori mbi zhvillimin e mesimit online.pdf; 85.FE\_Format pyetesori studenti.pdf]*

GVJ konstaton që NJSBC ka një regullore të operimit të saj dhe ka një tërësi mekanizmash dhe procedurash të integruara duke synuar kështu krijimin e një kulture cilësie me përfshirjen e të gjithë aktorëve, staf akademik, administrativ, studentë, drejtues, përfshirë edhe ekspertë të jashtëm.

*[9.UMT\_Rregullore e NJSBC.pdf; 121.Politika e zhvillimit të cilësisë në UMT.pdf]*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se NJSBC në nivel institucioni është krijuar në 2019, ka në përbërje të saj 6 anëtare, mes të cilëve një student, një ekspert të jashtëm për çështjet e cilësisë, përfaqësues nga cdo fakultet si dhe nga administrata. NJSBC në nivel institucioni, funksionon mbi rregulloren e miratuar.</p> <p><i>[7.UMT_VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf; 8.UMT_Përbërja e NJSBC.pdf].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me NJSBC, stafin dhe studentët rezulton se UMT përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit. Rezulton se nga NJSBC, zhvillohen pyetësorë para përfundimit të cdo semestri. Njësia kryesore dhe ajo bazë rezultojnë të zhvillojnë procese monitorimi, sipas një plani monitorimi. Planet mësimore dhe syllabuset, ndryshohen për të siguruar përputhshmërinë me bazën ligjore por edhe për tu përmirësuar.</p> <p><i>[11.UMT_Model i pyetësorit për studentet (Anketa).pdf; 10.UMT_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf; 90.FE_Shembull_Plan monitorimi për mësimdhënien.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Metodologjia e vlerësimit të cilësisë, rezulton të jetë e përcaktuar në Politikën e zhvillimit të cilësisë në UMT. Kjo metodologji përmban instrumenta të ndryshëm vlerësimi, si pyetësorët, monitorimi i proceseve mësimore, rezultatet e punës kërkimore shkencore të stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në UMT, rezultoi se informacioni i siguruar për cilësinë, nga instrumentat e mësipërm, mblidhet nga strukturat respektive, analizohet dokumentohet dhe iu përcillet organeve vendimmarrëse. Nga RVB dhe nga takimet me drejtues të njësive kryesore dhe asaj bazë, rezulton se realizohet analizë vjetore e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor të departamentit, për të identifikuar problematikat që mund të jenë shfaqur dhe për ti adresuar ato.</p> <p>Kjo analizë bëhet pjesë integrale e raportit vjetor në nivel institucioni si plotësim edhe i detyrimit ligjor për cdo IAL.</p> <p><i>[10.UMT_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf; 73.FE_Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

62

	<i>dhe financiar_ FE.pdf]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Null përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

**Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.

**Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.

**Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

**Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program

Nga vizita në institucion si dhe nga RVB, GVJ konstaton se NJSBC në nivel institucioni në koordinim më njësinë bazë, realizojnë në mënyrë periodike vlerësime të brendëshme. UMT e bën këtë vlerësim pjesë të vetëvlerësimeve periodike për qëllim të akreditimit të programit.

GVJ konstaton se rolin kryesor në nivel programor për vlerësimin e ka departamenti përgjegjës për PS Msc. Ekonomik-MBA. Ky vlerësim bëhet kryesisht për për planet mësimore, për syllabuset, për cilësinë e mësimdhënies etj. Prej NJSBC sigurohet informacion nga pyetësorët, që adresohen dhe kërkojnë informacion, për lëndët e PS Msc. Ekonomik-MBA, si dhe për pedagogët e këtyre lëndëve.

[11.UMT\_Model i pyetësorit per studentet (Anketa).pdf; 10.UMT\_Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik (rezultatet e vlerësimit NJSBC).pdf; 90.FE\_Shembull\_Plan monitorimi për mësimdhënien.pdf]

GVJ konstatoi se UMT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së PS Msc. Ekonomik-MBA përdor metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit si:

- a- Njëpërmjet monitorimit nga departamenti, vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe vëzhgime në auditor
- b- Kontroll të syllabuseve të lëndëve
- c- Përshtatje e planeve mësimore
- d- Vlerësim të organizimit të provimeve dhe detyrave të kursit

[90.FE\_Shembull\_Plan monitorimi për mësimdhënien.pdf]

GVJ konstatoi se UMT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së PS Msc. Ekonomik-MBA, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si:

- e- Sondazhe me studentët e programit, cdo semestër para fillimit të sezonit të provimeve
- f- Organizon takime me studentët, për tu thelluar në gjetjet e pyetësorëve, ku shpesh monitorimet planifikohen pas realizimit të takimeve me studentët
- g- Komisione Ad-hoc monitorimi, vlerësimi
- h- Pyetësor apo takime me studentët Alumni

[11.UMT\_Model i pyetësorit per studentet (Anketa).pdf; 82.FE\_Rrjeti Alumni UMT.pdf]



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka NJSBC, si njësi qëndrore në nivel institucioni, që ka të sanksionuar në statutin e UMT, detyrimin për implementimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UMT.</p> <p>NJSBC e garanton rolin e saj në bashkëpunim me njësinë bazë dhe atë kryesore, që janë përgjegjëse për programin e studimit Msc. Ekonomik-MBA. Vendimmarrjet për përmirësimin e cilësisë pas rezultateve të vlerësimit, merren dhe zbatohen kryesisht në nivel departamenti dhe njësie kryesore, sic janë rishikim planesh mësimore dhe syllabusesh, apo mbarëvajtja e mësimdhënies.</p> <p>Referuar takimeve me studentët dhe GVB, studentët janë të përfshirë dy herë në vit në plotësimin e pyetësorëve. Studentët e programit rezultuan gjithashtu pjesë edhe GVB. Studentët kanë edhe përfaqësuesin e tyre në NJSBC, që mbulon komunikimin me studentët për proceset vlerësuese.</p> <p>GVJ konstatoi se edhe nëpërmjet rrjetit Alumni që institucioni ka, nëpërmjet pyetësorëve me Alumni, si dhe takimeve që ka zhvilluar me ta, institucioni siguron informacion për përmirësimin e programeve.</p> <p>Pyetësorët zhvillohen anonim, duke ruajtur anonimitetin e përgjigjeve të studentëve. Departamenti përveç analizës së problematikave të hasura në tërësi, iu vendos në dipozicion në mënyrë individuale stafëve akademike të programit, rezultatet e vlerësimeve që studentët kanë bërë për lëndët që ata mbulojnë, pas përfundimit të procesit të provimeve dhe dorëzimit të procesverbaleve.</p> <p>Diskutimet zhvillohen mbi problematikat e mundshme, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë, kundrejt stafit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>[11.UMT_Model_i_pyetësorit_per_studentet_(Anketa).pdf; 82.FE_Rrjeti_Alumni_UMT.pdf]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk përmbushet	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

65

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>GVJ referuar DVV dhe ëebit zyrtar të UMT, konstaton se politika, e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. NJSBC mbështet në Politikën e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, për të cilën studentët informohen nëpërmjet guidës së studentit, ëebit zyrtar apo stafit të NJSBC</p> <p>GVJ konstatoi se UMT harton raportet e vlerësimit vjetor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale</p> <p>Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni nga takimet me stafin akademik, iu jepet individualisht stafeve për të respektuar të drejtën e informimit si dhe për të adresuar problematikat, por njëkohësisht edhe në respekt të integritetit të secilit.</p> <p>Nga vizita në institucion, rezulton se UMT organizon trajnime me stafin rreth proceseve të vetëvlerësimit apo vlerësimit të jashtëm. Nëpërmjet stafeve administrative të NJSBC dhe studentit pjesë e NJSBC, studentët marrin informacion për pyetësorët dhe synohet që të nxitet angazhimi i stafeve dhe studentëve si dhe ndërgjegjësimi për sigurimin e cilësisë në institucion</p> <p><i>[121.Politika e zhvillimit të cilësisë në UMT.pdf ; 104.FE_Aktivite të kryera nga studentët_qeveri studentore UMT-FE.pdf; 70.FE_Protokoll Nr. 392 Vendimet e Akreditimit i Programeve te Studimit APAAL.pdf]</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

## **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master I Shkencave "Ekonomik MBA" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana"**

### **Pikat e forta dhe afirmime**

1. Bashkëpunimi efektiv i strukturave drejtuese, akademike dhe mbështetëse në shërbim të programit të studimit
2. Sistemi i informacionit i integruar dhe efektiv.
3. Kurrikula bashkekohore.
4. Staf akademik me tituj dhe grada perfshire edhe staf akademik te huaj me kontrate me eksperience nderkombetare mësime
5. Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me mekanizma të diversifikuar dhe efektivë të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë.
6. Struktura mbështetëse efektive për studentët, për informimin e tyre rreth programit, mundësive të punësimit si dhe për programet e shkëmbimit te tyre.

### **Pika të dobta**

1. Hapësira fizike dhe kapacitetet pritëse të bibliotekës konsiderohen të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e studentëve të të gjithë programeve qe UMT ka.
2. Mungesa e përkthimit në gjuhën angleze të të gjithë dokumentacionit të programit.

### **Rekomandime**

1. Hapësira fizike dhe kapacitetet pritëse të bibliotekës konsiderohen të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e studentëve të të gjithë programeve qe UMT ka. Edhe pse nje mjedis qe fton studenët dhe një klimë e mirë aktuale, GVJ do të sugjeronte shtimin e kapaciteteve fizike, posteve pritëse dhe kompjuterave në bibliotekën e UMT
2. Përfundimi i përkthimit të dokumentacionit të programit në gjuhën angleze.

## **Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science "Economic MBA" offered by the Institution of Higher Education "Metropolitan University of Tirana"**

## Strengths and affirmations



1. Effective cooperation of management, academic and support structures in the service of the study program.
2. Integrated and effective information system.
3. Contemporary curricula.
4. Academic staff with titles and degrees, including foreign academic staff with contracts with international teaching experience.
5. Internal Quality Assurance System with diversified and effective mechanisms of quality monitoring and evaluation.
6. Effective support structure for students, to inform them about the program, employment opportunities and their exchange programs.

## Weaknesses

1. The physical space and reception capacities of the library are considered insufficient to meet the requirements of students of all programs that UMT has.
2. Lack of translation into English of all program documentation.

## Recommendation

1. The physical space and reception capacities of the library are considered insufficient to meet the requirements of students of all programs that UMT has. Although it is an environment that invites students and a good current climate, EEG would suggest increasing the physical capacity, reception posts and computers in the UMT library.
2. Completion of the translation of the program documentation into English.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

